
BULETIN INFORMATIV

Janar 2025

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së
Shkencave të Shqipërisë**

Janar, 2025

Përmbajtje

Aktivitete	6
Mbi takimin e zhvilluar me Kryeministrin Edi Rama dhe Kryetarin e Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, me anëtarët e Kryesisë, drejtues të instituteve dhe qendrave të përhershme të ASHSH-së dhe të sektorëve të administratës	7
Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim pune në mjediset e instituteve të albanologjisë, pjesë e ASHSH-së, me drejtuesit e saj e të instituteve e qendrave kërkimore të përhershme	12
Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të kryera për vitin 2024 dhe përparësitë për vitin 2025	14
Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të kryera për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025.....	19
U zhvillua takimi për raportin vjetor 2024 të veprimtarisë kërkimore-shkencore të Institutit të Arkeologjisë dhe parashikimet për vitin 2025	22
Analiza për vitin 2024 e veprimtarisë shkencore të Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës.....	25
Instituti i Historisë zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore-shkencore të vitit 2024 dhe detyrat kryesore për vitin 2025	27
Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore-shkencore të vitit 2024 dhe detyrat kryesore për vitin 2025.....	30
Instituti i Antropologjisë zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore-shkencore të vitit 2024 dhe projeksionet kryesore për vitin 2025.....	35
Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore-shkencore të vitit 2024 dhe projeksionet kryesore për vitin 2025	40
Biblioteka Shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Qendra për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor zhvilluan analizën vjetore për vitin 2024 dhe projeksionet për vitin 2025	46
Qendra e Studimit të Arteve prezantoi “Vjetarin artistik shqiptar”	50
Qendra e Kërkimeve në Bioteknologji dhe Gjenetikë prezantoi kërkimet shkencore të projektit “Sëmundjet autoimmune të sistemit nervor: algoritmet diagnostike dhe korelacionet imunogjenetike”	54

U zhvillua analiza e punës mbi veprimtarinë e njësisë së përkohshme të kërkim-studimit në fushën e energjisë së ripërtëritshme për vitin 2024.....	58
U zhvillua mbledhja e Komisionit fizikë-kimi për analizën vjetore të punës për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025.....	61
U mbajt workshop-i i projektit “Përdorimi i mjeteve molekulare për detektimin e hershëm të infektimit nga Fusarium & Vlerësimin e tolerancës ndaj faktorëve abiotikë në kultivarë lokalë të grurit (Triticum aestivum L.)”	64
U zhvillua takimi informues mbi thirrjet për projektet e financuara nga Agjencia Kombëtare për Kërkimin dhe Zhvillimin e Shkencës dhe Inovacionit	67
U zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare me temën “Thirre vendin tënd! Hapësira: kujtesë gjuhësore, historike dhe antropologjike”	70
Mbledhje të komisioneve të përhershme pranë ASHSH	77
U zhvillua mbledhja e Komisionit të mjekësisë për analizën vjetore të punës për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025.....	78
U zhvillua takimi për analizën mbi veprimtaritë e kryera nga Komisioni i përhershëm i gjuhësisë dhe i letërsisë për vitin 2024 dhe projeksionet e vitit 2025	81
U zhvillua analiza vjetore 2024 për veprimtarinë e Komisionit të arkeologjisë dhe projeksionet për vitin 2025.....	84
U zhvilluan takimet e 8 redaksive vendore Shqipëri - Kosovë për Enciklopedinë shqiptare	87
Komisioni i matematikë-informatikës zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore shkencore të vitit 2024	89
Komisioni i përhershëm i ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të 2024 dhe projeksionet e vitit 2025	92
Takime pune	95
U zhvillua një takim me përfaqësues të Ministrisë së Bashkëpunimit Rajonal të Izraelit dhe përfaqësues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.....	96
Të tjera.....	99
Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes shkrimtarin dhe akademikun e saj Fatos Kongoli	100

In memoriam.....	102
Kryesia e Akademisë së Shkencave kujton me nderim akademikun dhe shkrimtarin emblematic të letërsisë shqipe Ismail Kadare.....	103
Ndërroi jetë në moshën 79-vjeçare akademik emeritus Jani Vangjeli, botanist dhe specialist i florës së Shqipërisë	106
Fjala e lamtumirës e Kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi për akademik emeritus Jani Vangjelin	108
Fjala e lamtumirës në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave për akademik emeritus Jani Vangjelin, nga sekretarja shkencore e ASHSH-së, akad. Anila Hoda..	112
Letër ngushëllimi për ndarjen nga jeta të Kryepiskopit prof. dr. Anastas Janullatos	114
Ndahet nga jeta akademik Minir Dushi, një figurë e shquar e shkencës dhe arsimit në Kosovë dhe në hapësirën mbarëshqiptare.....	116

Aktivitete

Mbi takimin e zhvilluar me Kryeministrin Edi Rama dhe Kryetarin e Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, me anëtarët e Kryesisë, drejtues të instituteve dhe qendrave të përhershme të ASHSH-së dhe të sektorëve të administratës



Në takimin e realizuar më 24 janar 2025 me Kryeministrin Edi Rama, Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, në fjalën e tij falënderoi Kryeministrin për mundësinë dhe kohën për të diskutuar disa çështje me rëndësi të madhe për institucionin.

Në hyrje të takimit, Kryetari Gjinushi parashtroi një informacion të përmbledhur mbi veprimtarinë e Akademisë së Shkencave, e posaçërisht, mbi ecurinë e tri projekteve të albanologjisë e ngritjen e Qendrës së biogjenetikës, si dhe e njohu Kryeministrin me ristrukturimin e riorganizimin e instituteve të albanologjisë, e të qendrave të përhershme dhe njësitë e përkohëshme, duke theksuar se pranë ASHSH-së janë të aktivizuar si punonjës kërkimorë e bashkëpunëtorë rreth 500 specialistë të lartë.

Kryetari Gjinushi, duke falënderuar Kryeministrin për mbështetjen e dhënë në fazën e parë të reformës, kërkoi që kjo të vijojë edhe për fazën e dytë të reformës së Akademisë së Shkencave.

Ndër çështjet kryesore të përmendura prej kryetarit Gjinushi, për të cilat kërkohet mbështetje prej Këshillit të Ministrave dhe institucioneve qendrore ishin:

Së pari: Mjediset për muzetë, arkivat, institutet, qendrat dhe veprimtarinë akademike.

- Në kushtet aktuale, nevojat për mjedise për muzetë e arkeologjisë dhe etnografisë janë emergjente pasi fondet e tyre sot janë 80% të paeksponuara e në kushte magazinimi të papërshtatshme, deri në degradim.

- Nevojitet mbështetje për gjetjen e mjediseve për hapësira muzeale, si edhe hapësira për ambiente zyrash të punonjësve të Instituteve të Albanologjisë.

Kryeministri u informua se aktualisht Muzeu Arkeologjik ka potencialisht 2.200 objekte arkeologjike të ekspozuara dhe 15.000 të tjera në ruajtje.



Muzeu Etnografik nuk ka ambiente ekspozimi, ndërkohë, ka qindra objekte me vlerë si: flamuj kombëtarë të ngjarjeve më të rëndësishme historike, kostume popullore të të gjitha krahinave, objekte ari e argjendi, fond fotografish e disqesh, etj.

- Nevoja e rikonstruktimit të godinës së Akademisë së Shkencave dhe e Librit Akademik, si dhe ajo e dublimit të sallës së mbledhjeve.

- Kalimi i godinës së re pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) , për të cilën është rënë dakord në parim, në dispozicion të Njesisë Nano-Alb e përkohësisht të disa mjediseve të UBT-së, sipas propozimit të ministres së Arsimit.

Së dyti: Masat për rritjen e kapaciteteve në kërkimin shkencor sipas strategjisë për shkencën 2023-2030.

- Domosdoshmëria për një vendim të Këshillit të Ministrave në të cilin të specifikohen hapat konkretë në ngritjen e Qendrës Nano-Alb, ku të përcaktohen fazat,

mjediset, detyrat ndaj Akademisë së Shkencave, Bashkisë etj.

- Mbështetja e rritjes në perspektivë e kapaciteteve të Qendrës së biogjenetikës, instituteve të albanologjisë, sipas strategjisë për shkencën, si dhe konsultimi i statusit të Institutit të Fizikës Bërthamore e atij të Gjeo-Shkencave.

- PBA në të ardhmen të parashikojë mbështetjen e realizimit të ngritjes së strukturave të reja e të zgjerimit të kapaciteteve e të trajtimit financiar të instituteve të albanologjisë e qendrave të përhershme.

- Fondet për kërkimin shkencor në nivel kombëtar mbeten ende në nivele shumë të ulëta, nevojitet planifikimi financiar, ku të parashikohet që mbështetja me fondet buxhetore të shkojë të paktën në 1- 2% të GDP-së, si dhe mundësia për një rishikim të pagave të punonjësve kërkimorë-shkencorë që punojnë në institutet e ASHSH-së për t'u njësuar realisht me ato të institucioneve të arsimit të lartë.



Së treti: U trajtua problemi i kontributit të ASHSH-së në evidentimin e zgjidhjen e disa problemeve e përpilimin e strategjive në sektorë të rëndësishëm të arsimit, bujqësisë e ekonomisë në tërësi.

- Institutet e ASHSH-së bazuar në studime konkrete e gjithëpërfshirëse vlerësojnë se është i nevojshëm rishikimi i programeve shkollore në arsimin parauniversitar, posaçërisht në matematikë, fizikë e gjuhë shqipe, si dhe në shkencat natyrore në tërësi. Për dy të parat janë hartuar raportet e rekomandimet konkrete.

Kryeministri u informua se njësitë e ASHSH-së kanë punuar me programin e teksteve shkollore për lëndët matematikë-fizikë, pasi ka një handikap në sistemin e

arsimit parauniversitar; kemi një vit boshllëk, dhe nxënësit e shkollave të mesme sot nuk janë në nivelin e formimit të duhur.

Edhe programet e gjuhës shqipe kanë nevojë për ndryshime; që të jenë më të kapshëm, më harmonik e më të pëlqyeshme nga nxënësit, që të dalim nga gjendja e sotme ku pëlqehet më shumë mësimi i gjuhës angleze, se ai i gjuhës shqipe.

Këto studime janë ndërmarrë edhe me nxitjen e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave dhe me ministrin e Arsimit e është rënë dakord për hedhjen e hapave konkretë në këto drejtime.

- Siç dihet, pranë Akademisë së Shkencave funksionojnë disa njësi kërkimore të përkohshme e komisione të përhershme, pranë të cilave ka specialistë nga të gjitha institucionet arsimore-shkencore në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë e Veriut, e këtu lipset të institucionalizohet e koordinohet më mirë bashkëpunimi midis tyre e institucioneve ekzekutive e ministrive përkatëse për zbatimin e rekomandimeve të tyre.

Së katërti: U prekën çështje të marrëdhënieve me disa ministri, ku bashkëpunimi i ASHSH-së me to është i veçantë.

- Me Ministrinë e Arsimit, në zbatim të ligjit të ri për shkencën duhet të përcaktojmë statusin e posaçëm të instituteve të albanologjisë e qendrave të ASHSH-së për pjesëmarrje e bashkëpunim në programet e doktoraturës për fusha specifike.

- Nxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.

- Lipset t'i jepet hapësira ligjore e duhur të drejtës së instituteve kërkimore-shkencore për të kryer shërbime fitimprurëse.

- Është i nevojshëm përcaktimi i rolit e statusit të Institutit të Arkeologjisë në hulumtimet arkeologjike e në organizimin e siteve arkeologjike, bashkëpunimi i tyre me strukturat ekzekutive, duke filluar nga rregullimi i kuadrit ligjor, pasi Ligji për Trashëgiminë është i hartuar keq, ngatërrohet kërkimi shkencor me administrimin e organizimin e siteve arkeologjike.

Kryeministri Rama, pasi ndoqi me vëmendje gjithë çështjet e shtruara për diskutim në takim dhe vlerësoi rezultatet e reformës dhe punën e deritanishme të Akademisë së Shkencave, kërkoi në radhë të parë të njëjët me raportin e Institutit të Arkeologjisë me muzetë në vend, më konkretisht lidhjen që ka Instituti i Arkeologjisë i Akademisë së Shkencave me Muzeun Arkeologjik të Durrësit. Kryeministri Rama premtoi që do ta ndjekë me kujdes këtë problem, duke u konsultuar edhe me ministrin aktual të MEKI-t. Sa i takon ligjit për trashëgiminë dhe problematikave që ka shkaktuar zbatimi i tij, kryeministri Rama kërkoi nga Akademia dhe ekspertët e saj amendimet konkrete dhe një draft për ndërhyrjet në ligj.

Kryeministri Rama ndau idenë që me rikonstruksionin dhe riideimin e funksionimit të Muzeut Historik Kombëtar, fonde të muzeut të arkeologjisë dhe muzeut

të etnografisë të bëhen pjesë e MHK, ndarë në linja muzeale, në të cilën ai propozoi të përfshihej edhe gjuha shqipe, duke mirëkuptuar edhe kërkesën e ASHSH-së për të patur muze autonom me fondet e instituteve që janë dhe objekt i punës studimore.

Në lidhje me kërkesën për rritjen e fondeve për kërkimin shkencor kryeministri Rama garanoi mbështetje, por mbi bazën e studimeve konkrete dhe domosdoshmërinë e një harte të qartë se ku mund të jenë përfitimet në fushën e kërkimit shkencor. Lidhur me pagat e punonjësve të instituteve, kryeministri deklaroi se duhen parë, pasi sipas tij nuk ka kuptim që institutet që kanë nivelin më të lartë të kërkimit shkencor të kenë paga më të ulëta se universitetet.

Në lidhje me kalimin e njësisë kërkimore NANO-ALB në një qendër kërkimore të përhershme dhe vendosja e saj në ambientet e korpusit të UBT-së, sipas kryeministrit ishte një zgjidhje perfekt.

Kryeministri preku edhe mundësinë për hartimin e një strategjie, ku të ndërthuret bashkëpunimi midis qendrave dhe njësive kërkimore shkencore të ASHSH-së, ministrive të linjës dhe privatit për ofrimin e ekspertizës përmes certifikimit të produkteve si formë për gjenerimin e të ardhurave.

Kryeministri garanoi mbështetje të plotë të tij dhe të qeverisë që drejton për mbarëvajtjen dhe inkurajimin e mëtejshëm të nismave të ndërmarra për rritjen e nivelit të kërkimit shkencor në vend dhe ra dakord që takime të kësaj natyre janë të domosdoshme për nxitjen e rezultateve dhe përpjekjeve për të çuar përpara nismat e ndërmarra.

www.akad.gov.al

Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim pune në mjediset e instituteve të albanologjisë, pjesë e ASHSH-së, me drejtuesit e saj e të instituteve e qendrave kërkimore të përhershme



Para takimit kryeministri vizitoi mjediset e Muzeut Arkeologjik, i shoqëruar nga Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi, zëvendëskryetari, akad. Vasil Tole, drejtori Institutit të Arkeologjisë, akad. Adem Bunguri e përgjegjësi i muzeut.

Kryeministri Rama u njoh nga afër me fondin prej 100 mijë eksponentësh, dëshmi e patjetërsueshme e rrugëtimit mijërvjeçar të historisë së shqiptarëve.

Gjatë takimit akad. Gjinushi e njohu Kryeministrin me ecurinë e reformës në Akademinë e Shkencave, rezultatet kryesore të arritura, duke theksuar domosdoshmërinë e bashkëpunimit me Këshillin e Ministrave për zbatimin e Ligjit për Shkencën, për reformimin e sistemit të kërkimit, si dhe për nevojën e bashkëpunimit me institucionet qendrore për dhënien e ekspertizës për çështje të rëndësishme të zhvillimit të vendit si në arsim, bujqësi, energjetikë etj., në mënyrë që frytet e punës kërkimore të gjejnë zbatueshmëri.



Kryeministri Rama, duke vlerësuar punën e deritanishme të Akademisë së Shkencave, në drejtimin e akad. Skënder Gjinushit, garantoj mbështetje të plotë të tij dhe Qeverisë që drejton për mbarëvajtjen dhe inkurajimin e mëtejshëm të nismave të ndërmarra për rritjen e nivelit të kërkimit shkencor në vend, duke shprehur mirëkuptim për çështjet e ngritura.

<https://www.facebook.com/share/p/1C4Uu9mLLH/>
www.akad.gov.al

Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të kryera për vitin 2024 dhe përparësitë për vitin 2025

Në datën 30 janar 2025 u realizua takimi për analizën e veprimtarive të kryera për vitin 2024 dhe përparësitë për vitin 2025 të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, pjesë e ASHSH-së.

Takimi u zhvillua në praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi; kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akad. Gëzim Hoxha; sekretares së ASHSH-së, akad. Anila Hodo dhe anëtarëve të tjerë të Kryesisë e drejtuesve të instituteve dhe qendrave kërkimore të ASHSH-së.



Fillimisht, kryetari i ASHSH-së, akad. Gëzim Hoxha paraqiti raportin vjetor të punës kërkimore shkencore të këtij seksioni. Ai vuri në dukje se viti 2024 ka pasur si veçori kryesore integrimin e instituteve të albanologjisë në strukturën e Akademisë së Shkencave dhe veçoi hapat më të rëndësishëm të këtij procesi. Akad. Hoxha tha se ky vit ka shënuar një hap të rëndësishëm progresiv, sidomos në harmonizimin më të mirë të punës për realizimin më me sukses të tri projekteve madhore, të ndërmarra nga Akademia e Shkencave. Është punuar me prioritet në realizimin me sukses të dy projekteve madhore për Historinë e Shqiptarëve dhe Fjalorin e gjuhës shqipe.

Projekti i veprës “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” nisi në kuadër të reformimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, së bashku me dy projektet e tjera madhore: “Enciklopedia shqiptare” dhe “Historia e shqiptarëve”.

Për hartimin e veprës “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” u ngrit një grup i përbërë nga 55 bashkautorë e 25 hartues, të drejtuar nga një redaksi prej 10 leksikografësh në drejtimin e akademik Jani Thomait e akademik Valter Memishës. Në ndihmë të kësaj redaksie u krijua një qendër e posaçme, ajo e botimeve enciklopedike dhe albanologjike (QBEA). Njëkohësisht ka vazhduar puna konkrete dhe voluminoze nga redaksitë e fushave dhe redaksitë vendore dhe ajo qendrore për hartimin përfundimtar të fjalësve për projektin e tretë madhor të “Enciklopedisë shqiptare”.



Akad. Hoxha u shpreh më tej për integrimin e punës së instituteve (njësive) të albanologjisë, që e vlerësoi si një pasurim eksponencial të punës vjetore të Akademisë. Ai theksoi se SSHSHA-ja ka dhënë ndihmesë për hartimin e strategjive shumëvjeçare të instituteve, të cilat janë paraqitur dhe aprovuar në komisionet përkatëse të fushave. Më pas, ai paraqiti në mënyrë të detajuar volumin e madh të punës së Seksionit me institutet, qendrat dhe komisionet që ka në varësi, duke vënë në dukje se Akademia e Shkencave, dhe posaçërisht Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, ka ruajtur gjatë gjithë vitit një ritëm shumë të lartë të organizimit të aktiviteteve shkencore, promovuese, botuese dhe përkujtimore. Të mbledhura së bashku, rezulton se gjatë vitit 2024 janë kryer 108 aktivitete, 37 ndërkombëtare dhe 71 kombëtare, me 32 organizues, me 45 institucione pjesëmarrëse dhe me 615 referues. Po ashtu, kanë qenë të shpeshta bashkëpunimet me institucione kërkimore-shkencore apo shtetërore, universitete, organizata joqeveritare apo individë të shquar në fushën e shkencës, kulturës dhe artit.

Më tej, akad. Hoxha e vuri theksin tek aktivitetet dhe projektet më kulmore të realizuara nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, duke veçuar së pari

ato që janë bërë për gjuhën shqipe: konferenca “Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj” (4-5 nëntor 2024). Ky aktivitet u realizua si bashkëpunim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me Institutin e Gjuhësisë Krahësuese dhe Indoeuropiane, si dhe të Albanologjisë, pranë Universitetit “Ludwig Maximilian” të Mynihut, me pjesëmarrjen edhe të mjaft studiuesve nga institucione shumë të njohura të vendeve evropiane, ku referuan mbi 25 studiues e personalitete të rëndësishme të shkencës nga vendi dhe bota. Vlerësojmë se ky aktivitet i rëndësishëm shkencor është një risi në zhvillimin e aktiviteteve të Akademisë së Shkencave, pasi një drejtim krejt i ri i kërkimit shkencor të gjuhësisë historike, me ndihmën e inteligjencës artificiale, bëhet strumbullari i këtij prezantimi dhe debati shkencor produktiv. Nisur nga ky rezultat, kryetari i ASHSH-së, akad. Skënder Gjinushi, vuri në dukje se: “E vërteta shkencore ka nevojë të njihet e të pohohet. Popujt janë të ndjeshëm ndaj origjinës dhe gjuhës së tyre. Interesin e rrit fakti se çfarë po konfirmohet me studimet e reja, jo vetëm që nuk shkon kundër arritjeve të indoeuropeistikës, por vjen në përfundim, saktësim e pasurim të tyre.”



Akad. Hoxha shprehu falënderimet për organizatorët e këtij aktiviteti: akad. Shaban Sinani, prof. dr. Anila Omari, dr. Ledio Hala etj., që arritën ta realizojnë me cilësi shumë të lartë.

“Kuvendi i Gjuhës shqipe” dhe prezantimi i Fjalorit të madh më 21-22 nëntor 2024, janë gjithashtu dy ngjarje të rëndësishme. Akad. Hoxha theksoi se projekti i “Fjalorit të madh të shqipes” nuk plotëson vetëm arritjet dhe përgjegjësinë e marrë nga

Akademia e Shkencave e gjuhëtarët, nën drejtimin e akad. Jani Thomait e akad. Valter Memishës, por, përvoja e fituar, baza e të dhënave e krijuar mundëson mbarëvajtjen e tij të vazhdueshme e pasurimin e tij sipas zhvillimit të gjuhës sonë, dhe mbi të gjitha vijimin e punës për krijimin e thesarit të shqipes; këtë rol ka qendra e re e leksikografisë e themeluar me vendim të Këshillit të Ministrave e të Asamblesë.

Më pas ai foli edhe për risitë shkencore që u paraqitën në kuadër të aktivitetit “Ditët e Alfabetit 2024”, dedikuar Kongresit të Manastirit, që u zhvillua nga datat 14 deri më 22 nëntor 2024.

Së dyti, akad Hoxha vuri në dukje aktivitetet dhe projekte madhore për historinë, si: “80-vjetori i Çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë (25 nëntor 2024); konferenca për Revolucionin e Qershorit në jubileun e 100-vjetorit (24 qershor 2025); konferenca për Luftën e Parë Botërore (8 korrik 2024); konferenca për 25-vjetorin e Çlirimit të Kosovës (12 qershor 2024). Në vijim ai përmendi edhe veprimtari të tjera shkencore, si “Shqipëria – principatë e princ Vidit” (20 mars 2024); “Krijimtaria e At Shtjefën Gjeçovit në 150-vjetorin e lindjes” (14-15 shtator 2024).

Kryetari i SSHSHA-së vijoi me veprimtaritë që janë bërë për letërsinë, si: konferenca “Bajronizmi në Shqipëri” (30 maj 2024); konferenca “Naum Prifti mjeshtër i prozës së shkurtër” (12 mars 2024); veprimtaria përkujtimore për prof. Jup Kastratin (13 dhjetor 2024).

Në fushën e arkeologjisë kryetari i Seksionit akad. Hoxha spikati disa veprimtari të rëndësishme, si: konferenca “Viti arkeologjik 2023”; dita përkujtimore për arkeologun prof. Selim Islami” (3 maj 2024).

Në fushën e ekonomisë spikatën 2 veprimtari të rëndësishme referuar tematikave dhe problematikave të aktualitetit, siç janë konferencat me temë “Zhvillimet e kulturës digjitale – sfidat me të cilat do të përballemi” dhe “Zhvillimi ekonomik dhe ekonomia e mirëqenies”.

Arritje dhe veprimtari të zgjeruara ka pasur edhe në fushën e jurisprudencës, si: konferenca “Zhvillimi i konstitucionalizmit shqiptar” (2 korrik 2024); konferenca me temë: “Ndikimi dhe sfidat e arsimit të lartë në sektorët strategjikë të rajonit (17 tetor 2024).

Një punë e mirë është bërë edhe për antropologjinë dhe demografinë. Në rezultatet e punës vjetore të SSHSHA-së përfshihen arritjet dhe puna e bërë nga Instituti i Antropologjisë, ku theksohen dy veprimtari: Gjendja dhe perspektiva e arkivave të Institutit të Antropologjisë (9 nëntor 2024); “Studimi i qendrave të banuara, qytetare dhe rurale (Korçë, 13 dhjetor 2024).

Në raportin e kryetarit të Seksionit, një vend të veçantë zunë edhe botimet shkencore. Akad. Hoxha theksoi përrurimet e botimeve në panairin e librit akademik (22-26 prill 2024) dhe veçanërisht përrurimin e librit “Barleti i rigjetur” L. Nadin, A.

Plasari (4-5 prill 2024) etj.

Pas raportit të analizës vjetore u bënë diskutime për projektet e vitit 2025. Gjatë këtij takimi u diskutua me drejtuesit e instituteve dhe kërkuesit shkencorë pranë ASHSH-së për projekte të rëndësishme kombëtare dhe për botimet shkencore. U diskutua gjithashtu për pjesëmarrjen në konferenca dhe për nevojën e përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë së aktivitetit shkencor.

www.akad.gov.al

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të kryera për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025

Në datën 30 janar 2025 u realizua takimi për analizën e veprimtarive të kryera për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025 të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, pjesë e ASHSH-së.

Takimi u zhvillua në praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi; kryetarit të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, akad. Neki Frashëri; sekretares së ASHSH-së, akad. Anila Hodo dhe anëtarëve të tjerë të Kryesisë e drejtuesve të instituteve, seksioneve dhe qendrave kërkimore të ASHSH-së.

Fillimisht akad. Neki Frashëri paraqiti raportin e veprimtarive shkencore të SSHNT-së për vitin 2024. Ai paraqiti të dhënat përmbledhëse dhe citoi se SSHNT-ja ka ndërmarrë organizimin e 43 veprimtarive shkencore, si: konferenca, kongrese, kuvende, simpoziume, forume.



Kryetari i SSHNT-së vijoi me vlerësimin e përgjithshëm të veprimtarive shkencore me mbështetjen e komisioneve të përhershme sipas fushave kryesore: 36 projekte, 69 punime të botuara në revistat shkencore ose të prezantuara në konferencat shkencore, 18 botime si monografi, përmbledhje studimesh dhe libra.

Akad. Frashëri theksoi se njësitë e konsoliduara të nanoteknologjisë, bioteknologjisë dhe gjenetikës, si dhe më të rejat, si ajo e menaxhimit të ujërave dhe

gjeoshkencave kanë qenë mjaft aktive veçanërisht me projektet kërkimore. Njësia e energjive të rinovueshme ka pasur një veprimtari disi të fragmentuar për shkak të vetë karakterit multidisiplinor të termit, dhe ka pasur bashkëpunim të ngushtë me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës për projektin e përbashkët për alternativat energjetike.

Njësia e inteligjencës artificiale organizoi dhe realizoi me sukses konferencën ndërkombëtare "AI Horizon - A new era of creativity and innovation, ndërkohë që anëtarët e saj janë përfshirë në projekte të veçanta departamentale.

Dy njësitë "speciale" - institutet kombëtare të fizikës dhe të matematikës janë fokusuar më shumë në aspektet edukative, ku fizika është më shumë e mbështetur edhe nga lidhjet ndërkombëtare.



Në veçanti duhet theksuar konsolidimi si njësi kërkimore e përhershme e Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës me tre sektorë për gjenetikën dhe bioteknologjitë bimore dhe shtazore. Krahas këtyre drejtimeve, QKBGJ-ja ka filluar të shërbejë edhe si pikë fokale për veprimtaritë e tjera me drejtim shkencat e jetës dhe mjedisit.

Gjithashtu, akad. Frashëri vuri në dukje disa nga veprimtaritë me ndikim më të madh, si më poshtë:

Konferenca ndërkombëtare për Çarls Darwinin dhe kontributin e tij në biologjinë evolucionare, që u zhvillua në 215-vjetorin e lindjes. Në konferencë u prezantuan rezultate të biologjisë aktuale në frymën e teorisë së evolucionit, si dhe rëndësia e

trajtimit historik të konceptit të evolucionit.

Konferenca kombëtare e matematikës me rastin e 100-vjetorit të Petraq Pilikës dhe ndarja e çmimeve “Pilika”. Si një risi, Akademia ndërmori dhënien e çmimeve për studimet më të mira në matematikë të viteve të fundit me rastin e 100-vjetorit të akad. Pilikes - themelues i shkollës matematike të vendit.

Konferenca ndërkombëtare “NanoBalkan-2024”. Me krijimin e saj njësia e nanoteknologjisë me mbështetjen edhe të Institutit Katalan të Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë dhe të qeverisë shqiptare organizoi këtë konferencë ndërkombëtare me pjesëmarrje të gjerë nga vendet e tjera, përfshi edhe nobelistë. Konferenca ka shërbyer edhe si tryezë për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe me industrinë.

Konferenca ndërkombëtare “Për shëndetin publik dhe cilësinë e ajrit dhe ujit në Shqipëri: kusht i domosdoshëm për një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor”. Konferenca u organizua në bashkëpunim me komisionin e mjekësisë, njësitë kërkimore të bioteknologji-gjenetikës dhe të menaxhimit të ujërave, me pjesëmarrjen e shkencëtarëve nga Shtetet e Bashkuara etj.

Konferenca e Parë Kombëtare "Gjeoinxhinieria e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në Republikën e Shqipërisë: Alternativat për ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore", me pjesëmarrjen e kërkuesve nga vendi dhe rajoni, ku u diskutuan ndryshimet klimatike, menaxhimi i ujërave, ndryshimet mjedisore dhe ato bregdetare etj.

Pas raportit të analizës vjetore u bënë diskutime me drejtuesit e instituteve, qendrave, komisioneve dhe kërkuesit shkencorë pranë ASHSH-së për projekte të rëndësishme kombëtare dhe për botimet shkencore që do të realizohen gjatë vitit 2025.

www.akad.gov.al

U zhvillua takimi për raportin vjetor 2024 të veprimtarisë kërkimore-shkencore të Institutit të Arkeologjisë dhe parashikimet për vitin 2025

Në datën 13.01.2025 u realizua takimi për analizën vjetore të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe parashikimet për vitin 2025 të Institutit të Arkeologjisë, pjesë e ASHSH-së.

Takimi u zhvillua në praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi; sekretares shkencore të ASH-së akad. Anila Hoda; kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha dhe drejtorit të Institutit të Arkeologjisë akad. Adem Bunguri.



Fillimisht akad. Adem Bunguri paraqiti raportin e punës kërkimore shkencore të Institutit të Arkeologjisë për vitin 2024. Ai vuri në dukje se që nga data 01.01.2024, Instituti i Arkeologjisë është zyrtarisht pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Akad. Bunguri theksoi se: “Me këtë vendim u korrigjuan gabimet e reformës së vitit 2008 dhe më në fund, pas 15 vitesh, Instituti i Arkeologjisë si dhe institutet e tjera albanologjike, u rikthyen në shtëpinë e tyre. Është rasti të shprehim falënderimin dhe mirënjohjen tonë të veçantë për kryetarin e Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushin, për kontributin e tij vendimtar në realizimin e këtij akti të rëndësishëm

strukturor, për hapjen e Akademisë së Shkencave, për frymën e re dhe energjizimin e brendshëm të strukturave përbërëse të saj.”

Më tej akad. Bunguri tha se viti 2024 shënoi një vit të rëndësishëm për aktivitetin e Institutit të Arkeologjisë dhe për reformën strukturore dhe përmbajtësore të punës shkencore. Gjatë vitit 2024 kërkimet janë zhvilluar në drejtim të sqarimit të proceseve të neolitizimit dhe të indoeuropianizimit të territorit shqiptar, në studimin e qyteteve ilire në bregdet dhe në prapatokë, si dhe proceset transformuese që çuan në formimin dhe konsolidimin e tipareve të qytetërimit arbëror dhe në vazhdimësinë etnike iliro-arbërore.



Janë realizuar 25 projekte arkeologjike nga prehistoria, antikiteti, antikiteti i vonë & mesjeta, 15 prej të cilëve në bashkëpunim me universitete evropiane, dhe 10 projekte kombëtare. Gjithashtu u hartua dhe u miratua nga grupi i punës Strategjia e Kërkimit Arkeologjik për vitet 2025-2035.

Gjatë këtij takimi u diskutua me kërkuesit shkencorë për çështje të logjistikës dhe çështje të strategjisë së kërkimit shkencor. Diskutimet u fokusuan në projekte të rëndësishme kombëtare dhe për botimet shkencore. U diskutua gjithashtu pjesëmarrja në konferenca.

Diskutimi vijoi për ristrukturimin e departamenteve në strukturat e IA-së, si krijimi i një departamenti të Muzeut, Arkivit dhe Laboratorit të Konservimit, ku do të përfshihen gjithashtu edhe punonjësit ndihmësshkencorë, si dhe për statusin dhe karrierën e kërkuesit shkencor.

U kërkua gjithashtu hapja e shkollës doktrale pranë Akademisë së Shkencave. Shkolla doktrale e Institutit të Arkeologjisë dhe instituteve të tjera të Albanologjisë, që

nga viti 2014, është mbyllur nga qeveria, gjë që ka krijuar mjaft vështirësi në formimin e brezit më të ri të arkeologëve.



Në fund u bënë diskutime për projektet e vitit 2025. Gjatë diskutimeve u fol për nevojën e përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë së aktivitetit shkencor nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, rritjes së financimit dhe përmirësimit të mbështetjes administrative të projekteve. U theksua se produkti shkencor është etaloni i punës shkencore të studiueseve në veçanti dhe të Institutit në përgjithësi, ndaj u kërkua rritja dhe forcimi cilësor i tij.

www.akad.gov.al

Analiza për vitin 2024 e veprimtarisë shkencore të Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës

Në datën 09.01.2025 u realizua takimi për analizën vjetore të Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QKBGJ), pjesë e ASHSH-së.

Viti 2024 ishte viti i transformimit të QKBGJ-së nga një njësi e përkohshme në një qendër kërkimore të përhershme në kuadër të reformës së ASHSH-së. QKBGJ-ja përbëhet nga Sektori i biomjekësisë humane, Sektori i bioteknologjisë bimore dhe Sektori i bioteknologjisë shtazore.



Gjatë këtij viti qendra ka realizuar një aktivitet të dendur kërkimor në 18 projekte dhe ky aktivitet është pasqyruar në 26 konferenca apo simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, ai është konkretizuar në botimin e 8 artikujve shkencorë, nga të cilët 6 janë në revista ndërkombëtare të indeksuara dhe 2 në revista shkencore kombëtare.

Në sferën e biomjekësisë një nga projektet më të rëndësishme është krijimi i bankës së ADN-së të popullatës shqiptare, që është e domosdoshme për studimin e detajuar të lidhjeve gjenetike midis popullatës shqiptare dhe popullatave të tjera europiane.

Një projekt tjetër i rëndësishëm në këtë sektor, i cili ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e kujdesit shëndetësor, është studimi i markuesve imunologjikë dhe

gjenetikë në sëmundjet autoimmune. Këto patologji përbëjnë sot një problematikë të rëndësishme në sëmundshmërinë e përgjithshme dhe diagnoza e hershme e tyre është kyçe për përmirësimin e jetës së pacientëve të prekur.



Në sektorin e bioteknologjisë bimore janë realizuar projekte të rëndësishme për konservimin e materialit gjenetik të specieve bimore autoktone shqiptare, si dhe janë ndërmarrë strategji novatore për prodhimin e metaboliteve me efekte farmakologjike nga bimët mjekësore autentike shqiptare.

Sektori i bioteknologjisë shtazore është përqendruar në projekte që prekin integrimin e faktorëve gjenetikë dhe mjedisorë, që synojnë nxitjen e prodhimtarisë dhe ruajtjen e shëndetit të specieve të botës shtazore dhe faunës shqiptare.

Në analizë u diskutua dhe nevoja e përmirësimit dhe ngritjes së cilësisë së aktivitetit shkencor në këtë qendër nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, rritjes së financimit dhe përmirësimit të mbështetjes administrative të projekteve. Rritja e burimeve njerëzore të specializuara është një kërkesë tjetër e rëndësishme e kohës për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm në kërkimin shkencor në këtë qendër.

www.akad.gov.al

Instituti i Historisë zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore-shkencore të vitit 2024 dhe detyrat kryesore për vitin 2025



Në datën 14. 01.2025 Instituti i Historisë, pjesë e ASHSH-së, zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore-shkencore të vitit 2024 dhe detyrat kryesore të tij për vitin 2025.

Takimi u zhvillua në praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi; sekretares shkencore të ASH-së, akad. Anila Hoda; kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akad. Gëzim Hoxha, dhe kryetarit të Institutit të Historisë, akad. Hamit Kaba.

Fillimisht, akad. Kaba paraqiti raportin e punës kërkimore-shkencore të Institutit të Historisë për vitin 2024. Në fjalën e tij akad. Kaba theksoi se reforma e ndërmarrë bëri të mundur që nga data 01.01.2024, Instituti i Historisë të jetë zyrtarisht pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Aktiviteti integrues dhe bashkërendues me ASHSH-në kërkoi kohën dhe energjitë e veta, të cilat nuk e penguan apo ngadalësuan veprimtarinë shkencore të Institutit të Historisë.

Gjatë këtij viti shumica e kërkuesve shkencorë të Institutit të Historisë, duke shfrytëzuar buxhetin e këtij instituti, kryen kërkime shkencore në arkivat e vendeve të ndryshme (Itali, Britani, Turqi, Bullgari, Kroaci etj.), pjesëmarrje dhe promovime shkencore në konferenca ndërkombëtare në vende të ndryshme, si Austri, Francë, Britani, Kroaci, Greqi, Turqi, Itali etj.

Një pjesë e studiuesve të Institutit të Historisë janë angazhuar në tri projektet

madhore të ASHSH-së, si: Historia e shqiptarëve, vëllimi IV (Projekt i ASHSH-së); Enciklopedia Shqiptare (Projekt i ASHSH-së dhe ASHAK-ut), si dhe në projektin Historia e Kosovës (vëll. III, IV të Institutit të Historisë “Ali Hadri”) në Kosovë, i cili financohet nga qeveria e Kosovës. Studiuesit e këtij instituti janë përfshirë gjithashtu në 11 projekte ndërkombëtare. Ndër punimet kryesore të këtij instituti u përmendën:

- 2 monografi në proces botimi;
- 1 monografi në proces vlerësimi;
- 23 monografi në proces hartimi;
- 15 vëllime dokumentare/përkthime/përgatitje për botim të akteve të konferencave dhe 53 punime kritike dhe redaktime shkencore;
- Referime në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE-së dhe më gjerë, 16;
- Referime në konferenca shkencore ndërkombëtare brenda vendit, 40;
- Referime në konferenca dhe aktivitete shkencore kombëtare, 22;
- Referime në konferenca dhe aktivitete shkencore (Kosovë/Maqedoni V/Mali i Zi), 15;
- Botime ndërkombëtare (kapituj libri), 3;
- Artikuj shkencorë (vendet e BE/OECD), 12;
- Artikuj / kumtesa në “Studime historike” / “Albanian Studies”, “Kosova”, 26;
- Artikuj / kumtesa në revista në Scopus, 5.



Instituti i Historisë gjatë vitit 2024 vijoi publikimin online të revistës “Studime historike” ([https://ih- revista.edu.al/](https://ih-revista.edu.al/)) dhe publikimin në kohë të një numri nga viti

2023 dhe dy numrave të vitit 2024. Ndhmë për studiuesit në përgjithësi konsiderohet përpunimi i të gjithë numrave të revistës që nga viti 1964, botimi i bibliografisë së revistës “Studime historike” në vitet 1964-2024 etj. Në këtë drejtim një nga objektivat e IH-së është që gjatë vitit 2025 revista “Studime historike” të hyjë në procesin e indeksimit të revistës në SCOPUS.

Diskutimi vijoi me paraqitjen e projekt-strategjisë së Institutit të Historisë për 10 vitet e ardhshme, me ristrukturimin e departamenteve, nevojën për studiues të rinj, veçanërisht për periudhën e antikitetit dhe të mesjetës, me rrugët për rekrutimin e studiuesve me gjuhë të rralla, si: latinishtja, greqishtja e vjetër dhe ajo mesjetare, osmanishtja etj. U diskutua, gjithashtu, për projektet e parashikuara për vitin 2025 dhe për bashkëpunimin me institucionet homologe, në mënyrë të veçantë me Institutin e Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë.



U kërkua dhe u gjet mirëkuptimi me kryetarin e ASHSH-së akad. Skënder Gjinushi për shumë çështje, ndërmjet të cilave për arritjen e një marrëveshjeje favorizuese për marrjen e dokumenteve nga Arkivi Qendror i Shtetit, për sigurimin e mjediseve të punës për studiuesit etj. Gjatë diskutimeve u fol për përmirësimin e cilësisë së studimeve të këtij instituti, për përmirësimin e infrastrukturës, për rritjen e fondit të financimeve e më gjerë.

www.akad.gov.al

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore-shkencore të vitit 2024 dhe detyrat kryesore për vitin 2025



Në datën 15 janar 2025 u realizua takimi për analizën vjetore të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe parashikimet për vitin 2025 të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pjesë e ASHSH-së.

Takimi u zhvillua në praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi; sekretares shkencore të ASH-së akad. Anila Hoda; kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha dhe drejtorit të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë akad. Valter Memisha.

Fillimisht akad. Valter Memisha paraqiti raportin e punës kërkimore shkencore të IGJL-së të zhvilluar gjatë vitit 2024.

Ai tha se në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave të datës 31 maj 2023 dhe VKM-së së 28 dhjetorit 2023, "Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë", Instituti i Gjuhësisë dhe të Letërsisë, së bashku me institutet e tjera të Albanologjisë, u rikthye pranë Akademisë së Shkencave.

Me mbështetjen e hapur të Kryesisë, të Asamblesë së Akademisë dhe të vetë kryetarit të Akademisë akad. Skënder Gjinushit, natyra e institucionit nuk u tjetërsua dhe arritja më kryesore është se nuk u kufizua liria akademike në shumanshmërinë e vet, sidomos në punën studimore e në kërkimin shkencor. Objekti i punës kërkimore e

shkencore mbeti ai për të cilin IGJL-ja kishte punuar për 72 vjet dhe me të cilin u identifikua me punën e vetë dhjetëvjeçare. Ai tha se gjatë këtij viti, në kuadrin e reformimit të plotë ndërinstitucional, u punua për të dhënë ndihmesë dhe nga IGJL-ja edhe për plotësimin e kuadrit ligjor dhe për hartimin e ligjit për shkencën, për hartimin e statutit të Akademisë së Shkencave e të rregullores së funksionimit të brendshëm etj.



Një vend të rëndësishëm në punën tonë institucionale të drejtuar nga Kryesia e Akademisë, zunë diskutimet për revistën shkencore “Studime filologjike”, për indeksimin e saj sipas kërkesave të botimeve shkencore ndërkombëtare.

Akad. Memisha përmendi edhe disa arritje të tjera: Në kuadrin e ristrukturimit dhe të lirisë Akademisë gjatë viti 2024 u arrit organizmi strukturor më i mirë, më i drejtpërdrejtë e më afër kërkimit shkencor, të IGJL-së dhe në mënyrë të pandashme me këtë, hartimi dhe diskutimi me përgjegjësi i strategjisë së punës shkencore afatshkurtër, afatmesme, por edhe afatgjatë.

Gjatë vitit 2024 Këshilli shkencor i Institutit u plotësua 4 me anëtarë të rinj, me profesorë nga Universiteti i Tiranës, nga Universiteti i Elbasanit, nga Universiteti i Napolit.

Më tej akad. Memisha tha se gjatë viti 2024 u bënë studime për dialektet e gjendjen e sotme të shqipes, studime për historinë e saj, punë për hartimin e

gramatikave shkencore dhe të fjalorëve shpjegues e terminologjikë; për trajtimin e çështjeve të shqipes standarde, të normës gjuhësore e të kulturës së gjuhës, në fushën e historisë së letërsisë për zhvillimin historik të letërsisë shqiptare, për jetën dhe veprën e përfaqësuesve të saj më të shquar, që i kanë shërbyer hartimit të veprave përgjithësuese historiko-letrare, si dhe punës për të përgatitur botime kritike-shkencore të përfaqësuesve të traditës letrare.



Akad. Memisha theksoi se janë realizuar projekte të rëndësishme kombëtare e ndërkombëtare si “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” (Projekt i Akademisë së Shkencave) ku institucionet pjesëmarrëse janë Departamenti i Gjuhësisë të IGJL dhe hartues e bashkëpunëtorë nga Universitete të Shqipërisë, të Kosovës e të Maqedonisë së Veriut (Koha e realizimit 2021-2025).; po punohet për Projekt Korpusin elektronik të gjuhës shqipe, i cili deri tani ka afër 800.000.000 njësi (fjalë, fjalëformash të regjistruara nga burime të shumta shkencore, artistike, publicistike etj, si dhe për Enciklopedinë e popullit shqiptar.

Janë realizuar projekte të tjera brenda Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë si:

“Fjalori i termave të gjuhësisë, të letërsisë dhe të retorikës (projekt me pjesëmarrjen e të gjithë punonjësve të IGJL-së), 2024-2026;

Krijimi i radhoit elektronik të toponomastikës (2024-2026) (Digjitalizimi i skedave të toponomastikës në arkivin e IGJL-së) etj.

Gjithashtu, akad. Memisha raportoi realizmin e 12 projekteve brenda departamenteve të ILGJ-së (përveç projekteve në kuadrin e Akademisë së Shkencave).

Ai tha se një punë serioze dhe vullnetplotë është zhvilluar dhe në vitin 2024 në kuadër të evidentimit, skedimit dhe ruajtjes së pasurisë arkivore të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Ai foli edhe për punën kërkimore e përgatitore që është bërë për fjalorin e termave të gjuhësisë, letërsisë, retorikës për pjesën e studimeve letrare.

Gjatë raportimit akad. Memisha foli për botimin e monografive, përmbledhjeve me studime, fjalorëve, bibliografive shkencore, artikujve studimorë të botuar në gjuhë të huaj; artikuj në revista e periodikë të IGJL-së ose në revista të tjera shkencore që janë hartuar nga IGJL-ja, si dhe për veprimtaritë shkencore (konferenca, simpoziume, tryeza, kolokiume) rajonale, kombëtare e ndërkombëtare.



Ai vlerësoi edhe punën e studiuesve dhe akademikëve pranë IGJL-së në udhëheqje diplomash në nivelin bachelor, master, tezë doktorale, në pjesëmarrje në komisione për mbrojtje doktorature, si dhe për punën e bërë gjatë ekspeditave kërkimore, dhe me gjerë për botimet dhe krijimtarinë artistike.

Më pas u diskutuan planifikimet e IGJL-së për vitin 2025, mes të cilave përfshihen:

Projekte kërkimore, duke vijuar me përgatitjen për botimin e “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe”; krijimi i radhorit elektronik të toponomastikës së Shqipërisë; projekte mbi zhvillimet bashkëkohore në fushën e semantikës gjuhësore; projekti ndërkombëtar “Intonation in Albanian Dialects” (Intonacioni në dialektet e shqipes); ekspeditat kërkimore të planifikuara në disa qarqe të Shqipërisë në kontekstin e projekteve të ASHSH-së etj.

Në kuadër të veprimtarive për vitin 2025 janë edhe Kongresi XIII i AIESEE-së organizuar nga ASHSH-ja që do të mbahet në shtator 2025, si dhe konferenca për kulturën arbëreshe që do të mbahet në tetor të këtij viti, konferencat për 300- vjetorin e Pjetër Budit e të Pjetër Bogdanit, etj.

Gjatë këtij takimi, kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Gjinushi foli për kontributin e ASHSH-së në hartimin e miratimit të ligjit të ri për shkencën, për punën e bërë nga bordi i drejtorëve, nga Kryesia e Akademisë e Asambleja në hartimin e akteve nënligjore që lidhen me statusin e kërkuesve shkencorë, botimet periodike, etj. Ai theksoi se parashikimi tashmë edhe me ligj, ashtu si dhe në statut, i kategorizimit të punonjësve kërkimor shkencor, gëzimi prej tyre i të njëjtit status si në institucionet e arsimit të lartë, përcaktimi i rregullave të qarta për mbështetjen e specializimit a lëvizshmërisë së tyre, përmirësojnë e forcojnë ushtrimin e lirive akademike të tyre.

Akad. Gjinushi theksoi se ligji i shkencës iu jep një status e liri më të plotë instituteve sesa ai i arsimit të lartë, e së bashku me ligjin e ASHSH-së tashmë garanton një autonomi të plotë të tyre, veçanërisht në administrimin e buxhetit, ndërsa organeve drejtuese këshill shkencor e drejtor iu jepet autoriteti i duhur, siç e tregoi dhe përvoja e këtij viti të parë të funksionimit të instituteve pranë ASHSH-së.

Për të ardhmen u theksua rëndësia e hartimit të një strategjie ambicioze e të realizueshme, përqendrimi i punës në projekte madhore, afrimi i bashkëpunëtorëve e hapja ndaj institucioneve të tjera, si dhe vlerësimi mbi kritere sa më profesionale të punës së gjithësecilit për të kaluar në rankimin e instituteve e të punonjësve kërkimor shkencor, siç e parashikon ligji për shkencën.

www.akad.gov.al

Instituti i Antropologjisë zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore-shkencore të vitit 2024 dhe projeksionet kryesore për vitin 2025

Më 16 janar 2025 u zhvillua takimi për analizën vjetore të veprimtarisë së punës në Institutin e Antropologjisë, pjesë e ASHSH-së.

Të pranishëm ishin kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi; zëvendëskryetari i ASHSH-së akad. Vasil Tole; sekretarja shkencore e ASHSH-së akad. Anila Hoda, drejtori i Institutit të Antropologjisë prof.asoc.dr. Olsi Lelaj dhe anëtarë të Institutit.



Takimi filloi me paraqitjen e raportit të punës kërkimore-shkencore dhe arritjet në realizimin e planit brenda objektivave të parashikuara në fillim të vitit 2024.

Prof. asoc. Lelaj u ndal te puna kërkimore-shkencore e studiuesve të IA-së, ku gjatë vitit kanë botuar 17 artikuj shkencorë në revista shkencore vendëse dhe të huaja, si dhe kanë ligjëruar kumtesa në 36 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, krahas përfshirjes së tyre në procesin e mësimdhënies në lëndë profili në universitete vendëse dhe të huaja. Në analizë u theksua edhe përfshirja e studiuesve të Institutit të Antropologjisë në veprimtari botuese, të cilat kryesisht lidhen me përpunimin dhe redaktimin e materialeve arkivore në kuadër të vijimit të projektit: Kolana e botimeve “Etnografi në diktaturë”.

Janë përgatitur për botim 8 monografi me fokus dihebërjen e qeramikës, minoritetet, lojërat popullore dhe bibliografi shkencore. Janë botuar dy vëllime të

revistës “Antropologji”.

Revista “Antropologji” 2023 i është kushtuar tërësisht punës kërkimore të zhvilluar në kuadër të projektit kërkimor “Atlasi etnografik i fshatit shqiptar sot”, ku janë përfshirë përmasat e kërkimit të zhvilluar në këtë projekt me tema, si: emigrimi, shndërrimet kulturore, hapësira tingëllore, praktikat e reja folklorike dhe pandemia, financuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Aktualisht projekti vazhdon dhe mbështetet nga fondet e Akademisë së Shkencave.

Revista “Antropologji” 2024 përmbledh artikuj studimorë të studiuesve të Institutit të Antropologjisë dhe bashkëpunëtorëve të tij, me tema, si: shoqëria civile, identiteti urban, antropologjia urbane, filmi etnografik, historia e disiplinës së muzikologjisë, kujtesa historike dhe shkrimi, dijeberja e xhubletës, folklori i Arbëreshëve të Zarës.



Prof. asoc. Lelaj vuri në dukje se gjatë vitit 2024 u zbatuan 8 projekte, ku veçoi nisjen e zbatimit pranë Institutit të Antropologjisë të projektit “Digjitalizimi, krijimi i Skedarit të Parë Kombëtar Toponomastik (2024-2026)”, i mbështetur nga AKKSHI. Ky projekt është ndër arritjet kryesore të Institutit të Antropologjisë në këtë vit dhe deri më tani ka bërë bashkë mbi 100 pjesëmarrës në zbatimin e tij dhe në të cilin janë digjitalizuar mbi 70 mijë skeda toponomastike. Gjithashtu, ai theksoi se edhe ngritja e Laboratorit të Restaurimit në Institutin e Antropologjisë, në funksion të restaurimit të fondeve arkivore, mbështetur financiarisht nga Akademia e Shkencave, duhet veçuar si një rezultat me rëndësi për vitin 2024. Në bashkëpunim me Muzeun Kombëtar të

fotografisë “Marubi”, u çel në Shkodër ekspozita fotografike “Vëllezërit Kodheli dhe Kol Idromeno”. Këtu u ekspozuan fotografi nga fondi fotografik i Kol Idromenos. Kjo ekspozitë u vizitua nga më shumë se 7500 vizitorë vendës dhe të huaj.

Drejtori i IA-së u ndal tek arritjet e bashkëpunimeve ndërkombëtare gjatë vitit 2024. Ai vuri në dukje disa nga këto arritje, si intensifikimi i marrëdhënieve me Shkollën Franceze të Athinës, Seksioni i Historisë Moderne dhe Bashkëkohore, një marrëdhënie e cila është pjesë e marrëveshjes kuadër të nënshkruar mes Shkollës Franceze të Athinës dhe ASA-së. Gjithashtu, ai përmendi nisjen e punës së përbashkët për zhvillimin dhe aplikimin e një projekti madhor europian në fushën e antropologjisë të emigracionit, me fokus gjeneratën e dytë dhe të tretë të emigrantëve shqiptarë në Greqi.



Instituti i Antropologjisë si institucion partner, në një konsorcium institutesh dhe universitetesh europiane, dhe në drejtimin e Shkollës Franceze të Athinës, do të ketë një rol kyç në këtë projekt me kërkime që do të zhvillohen në Shqipëri dhe në Greqi. Gjatë vitit 2025 do të përgatitet dosja e aplikimit të këtij projekti të madh europian. Po ashtu, Shkolla Franceze e Athinës po zhvillon një projekt mbi folklorin në zonat kufitare gjatë vitit 2025, në të cilin Instituti i Antropologjisë do të jetë institucion partner. Pjesë e bashkëpunimit mes Institutit të Antropologjisë dhe Seksionit të historisë moderne dhe bashkëkohore është organizimi i një konference të përbashkët ndërkombëtare në Athinë gjatë vitit 2025.

Më tej, prof. asoc. Lelaj tha se Instituti i Antropologjisë ka bërë gati aneksmarrëveshjet me Institutin e Etnografisë dhe Institutin e Antropologjisë të Akademisë së Shkencave të Rumanisë, të cilat do të finalizohen gjatë vitit 2025. Ai përmendi gjithashtu edhe vijimin e zbatimit të projektit ndërkombëtar Seeffield gjatë vitit 2024, që drejtohet nga Universiteti i Regensburgut, Gjermani, në të cilin Instituti i Antropologjisë është partner. Në këtë kuadër, prof. asoc. dr. Mikaela Minga ishte e ftuar në Universitetin e Regensburgut me një cikël ligjëratah për zhvillimet në etnomuzikologji, hapësirën urbane dhe hapësirën tingëllore në Europën Juglindore.

Projeksionet e Institutit të Antropologjisë për vitin 2025

Prof. asoc. dr. Olsi Lelaj paraqiti projeksionet për vitin 2025. Ai theksoi se sfidat kryesore për Institutin e Antropologjisë janë nisja e zbatimit të Strategjisë së re të Kërkimit Shkencor të Institutit të Antropologjisë. Pasi foli për hapësirat e reja që ofron Ligji i Ri për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor, ai vuri në dukje se pjesë e programit të punës për Institutin e Antropologjisë do të jenë ngritja në bashkëpunim me një nga institucionet e arsimit të lartë të vendit e një programi master dhe doktorature në antropologji kulturore.



Në mbështetje të projektit “Digjitalizimi, krijimi i Skedarit të Parë Kombëtar Toponomastik” (2024-2026), do të merren hapat e duhur institucionale për ngritjen e Laboratorit të Antropologjisë Gjuhësore, si sektor i ri kërkimor i Institutit. Përveç vijimit të projekteve kërkimore vetjake të studiuesve të lidhura me projektin “Atlasi etnografik

i fshatit shqiptar sot: thellime zonale”, që mbështetet nga Akademia e Shkencave, do të ndërmerren hapat e nevojshëm institucionalë për propozimin e platformës për muzeun shkencor të etnografisë, i konceptuar si arkivi i hapur i etnografisë. Së fundi, organizimi i një konference ndërkombëtare të përbashkët me Shkollën Franceze të Athinës dhe me Institutin e Antropologjisë, me fokus dija antropologjike dhe diktaturat në Mesdhe, e projektuar për t’u mbajtur në Athinë, janë disa nga projeksionet e punës kërkimore për vitin 2025.

Drejtuesit e departamenteve të Institutit të Antropologjisë dhe të projekteve prezantuan punën e tyre dhe diskutuan me Kryetarin e ASHSH-së akad. Gjinushin për ecurinë dhe rëndësinë specifike që mbajnë projektet kërkimore.

Akad. Gjinushi i përgëzoi për arritjet dhe punën e bërë dhe diskutoi me ta për rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë dhe me qendrat e tjera të kërkimit në vend dhe jashtë vendit.

Akad. Gjinushi theksoi se është me rëndësi shfrytëzimi i hapësirave të reja juridike që jep ligji i ri për shkencën për krijimin e institucioneve të tjera të arsimit të lartë, të programeve të ciklit të dytë dhe të tretë të sistemit master dhe doktoraturë.

Ndër të tjera, akad. Gjinushi vuri në dukje kontributin e ASHSH-së në hartimin dhe miratimin e ligjit të ri për shkencën, për punën e bërë në hartimin e akteve nënligjore, që lidhen me statusin e kërkuesve shkencorë në kornizat e këtij ligji dhe përpjekjen për të bërë shkollën e doktoraturës pranë ASHSH-së.

Në fund të diskutimeve, akad. Gjinushi premtoi mbështetjen e plotë institucionale për fondet për arkivat dhe hapjen e muzeut shkencor etnografik. Ai e vuri theksin te rritja e cilësisë së punës kërkimore dhe domosdoshmërinë për fonde në mbështetje të kërkimit dhe adresimit të sfidave në gjetjen e fondeve financiare në funksion të restaurimit të fondeve arkivore.

www.akad.gov.al

Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore-shkencore të vitit 2024 dhe projeksionet kryesore për vitin 2025



Më 15 janar 2025 u zhvillua takimi për analizën vjetore të veprimtarisë së punës në Qendrën e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike (QBEA), pjesë e ASHSH-së.

Takimi u zhvillua në praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi; zëvendëskryetarit të ASH-së akad. Vasil Tole; sekretares shkencore të ASH-së akad. Anila Hoda; kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha dhe drejtorit të Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, dr. Arian Leka.

Dr. Arian Leka paraqiti raportin e punës kërkimore shkencore të zhvilluar gjatë vitit 2024. Fillimisht ai foli për strukturat dhe funksionet e Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, e cila filloi funksionimin një vit më parë, si njësi e specializuar në aspektin shkencor dhe teknik që, me strukturën e vet, mbështet me të gjitha kapacitetet projektet madhore aktuale të albanologjisë: si: Fjalorin e madh të gjuhës shqipe, Historinë e shqiptarëve dhe Enciklopedinë shqiptare. QBEA-ja përbëhet nga dy sektorë: një për Leksikografinë dhe Korpusin për gjuhën shqipe dhe një sektor

për Enciklopedinë shqiptare.

Nga ana organizative, nga janari 2024 deri në momentin e raportimit, QBEA-ja e plotësoi përfundimisht organigramën e strukturës së vet.

Veprimtaria e QBEA-së gjatë vitit 2024 është përqendruar në mbështetjen dhe administrimin nga pikëpamja organizative, teknike, shkencore dhe financiare të tri projekteve madhore në albanologji, si nisma dhe realizime të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë: Fjalori i madh i gjuhës shqipe; Historia e shqiptarëve;

Enciklopedia shqiptare:

“Fjalori i madh i gjuhës shqipe”

Viti 2024 shënoi periudhën më intensive të fazës përmbyllëse të projektit dhe dorëzimin e tij në version pune, përfshi edhe promovimin.

Spektori i Leksikografisë dhe Korpusit për Gjuhën Shqipe pranë QBEA-së ka kryer detyra e procese të veçanta në aspektin profesional, në fushën e administrimit të materialit, të ruajtjes dhe përpunimit në aspektin teknik dhe procesimit të tij në aspektin profesional të përfaqësimit në formën digjitale. Të tilla janë pajisja e Kartotekës digjitale me programe leksikografike bashkëkohore dhe shfrytëzimi njësisë të digjitalizuar përmes një platforme të personalizuar kërkimi.

Me kërkesë të redaksisë së “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe” u ndërtua platforma e posaçme web e “Fjalorit të madh të gjuhës shqipe” (ku janë hedhur dhe ruajtur në baza të veçantë të dhënash të gjithë fjalorët shpjegues të Akademisë së Shkencave deri më sot).

U krijua një bazë të dhënash elektronike e përbërë prej 800 milion njësisish, në të cilat u përfshinë dhe u përpunuan dhe janë vënë në dispozicion 29 fjalorë të mëhershëm të shqipes, mes tyre fjalorë shpjegues, etimologjikë, sinonimikë, frazeologjikë, drejtshkrimor etj, dhe veprat e autorëve më të përmendur shqiptarë, që nga fillimet e shkrimit shqip.

Fjalori i madh i gjuhës shqipe, si përgjegjësi e përmbushur nga Akademia e Shkencave, u plotësua me ngritjen e grupit të IT, për proceset që lidhen me krijimin Kartotekës elektronike / Korpusit elektronik dhe me krijimin e formatit online të veprës.

“Historia e shqiptarëve”

Gjatë vitit 2024 puna për përfundimin e versionit final të dy vëllimeve të para të projektit Historia e shqiptarëve (Lashtësia dhe Mesjeta) ka qenë intensive.

Vëllimi II – Mesjeta: Vepra e përfunduar, siç është dorëzuar pranë QBEA-së përmban 722 faqe në version elektronik në word, formatuar sipas standardeve.

Lënda e V. II – Mesjeta, ka përfunduar redaktimin shkencor, por ka nevojë për redaktim letrar, për t’i hapur rrugë procesit të faqosjes paraprake.

Më 2 dhjetor 2024, Këshilli Shkencor i QBAE-së, mori në shqyrtim materialin

përfundimtar të dy veprave të projektit Historia e shqiptarëve: vëllimi I - Lashtësia dhe vëllimi II – Mesjeta, i cili u është shpërndarë në version të printuar paraprakisht autorëve dhe anëtarëve nga QBEA-ja.

Veprat kanë ndjekur metodologji bashkëkohore të historiografisë shqiptare e të huaj, duke sjellë risi përballë teksteve me tematikë të ngjashme botuar më herët si dhe gjuhë të unifikuar në stil. Lënda shkencore e paraqitur në tekstet e dy vëllimeve të para të projektit madhor “Historia e shqiptarëve”, i përmbush kërkesat e shprehura e të synuara, duke i hapur rrugën fazave të tjera të punës, deri në publikim. QBEA po ndjek procesin deri në përfundim.



Enciklopedia shqiptare

Enciklopedia shqiptare përbën veprën më komplekse dhe më voluminoze mes projekteve të përbashkëta të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, gjithashtu edhe sfidën më të madhe të kërkimit shkencor shqiptar, mbështetur nga qeveritë në Shqipëri dhe Kosovë.

Gjatë vitit 2024, QBEA - realizoi një në kalendar të ngjeshur takimesh për të gjitha nivelet e redaksive, si dhe takime të përbashkëta mes redaksive të fushave gjegjëse Shqipëri – Kosovë.

Takimet e morën nismën nga problematikat dhe çështjet për zgjidhje që institucionet e brendshme që drejojnë projektin e Enciklopedisë Shqiptare adresuan ndaj njëra-tjetrës, si dhe kërkesat e parashtruara nga Kryeredaktori i ESH, akad. Skënder Gjinushi, drejtuesi i redaksisë vendore Tiranë, të cilët drejtuan procesin në bashkëpunim dhe koordinim me instancat homologe në Kosovë.

Këtyre takimeve u parapriu workshop-i udhëzues i datës më 30 prill 2024, me pjesëmarrjen e redaksisë vendore Tiranë, të 27 redaksive të fushave (Shqipëri) dhe redaksisë së posaçme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që diskutoi çështje të zbatimit të kriterëve shkencore bazë për miratim, referimet ndaj udhëzuesit praktik dhe hartimin e fjalësit paraprak të artikujve enciklopedikë për çdo fushë.

Nga 26 prilli deri më 30 prill 2024, sektori i Enciklopedisë shqiptare pranë QBEA-së, plotëson organigramën me marrjen e detyrës së përgjegjësit të sektorit të Enciklopedisë shqiptare nga dr. Arian Leka, ku u organizuan një seri takimesh për procesin e njësimit të fjalësit të këtyre mes redaksive të fushave gjegjëse Shqipëri – Kosovë.

Gjatë muajit maj 2024, po nga i njëjti grup i sektorit, prej datave 10 deri më 23 maj 2024, QBEA-ja organizoi një seri tjetër takimesh të redaksive Shqipëri –Kosovë, ku redaksitë gjegjëse fillojnë fazën e parë në procesin e shkëmbimit të fjalësit dhe kalimin nga fjalësi i përbashkët (i njësuar) drejt fjalësit të stabilizuar.



[Gjatë muajit shtator u zhvilluan edhe takimet dypalëshe online mes disa redaksive të Tiranës që punonim me fjalës të bashkuar, me redaksinë e posaçme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shqyrtim e rishqyrtim kritik-përzgjedhës të fjalësve të fushave të tyre dhe diskutimin e përfshirjes së propozimeve prej tyre.

Këto takime, që zgjatën deri më 10 shtator 2024, iu paraprinë takimeve të

Prishtinës 16-26 shtator 2024, ku sektori i Enciklopedisë shqiptare ishte bashkorganizator në takimet mes 27 redaksive në Shqipëri dhe 29 redaksive gjegjëse në Kosovë, ndërkohë që i gjithë procesi u ndoq me prani nga akad. Shaban Sinani dhe dr. Arian Leka.

Gjatë takimeve u kërkua zbatim i një standardi të vetëm dhe e njëjta disiplinë shkencore në zbatim për fjalësin e integruar.

Numri i redaksive që punuan me fjalës në formë të bashkuar shkoi nga 15 në 21 redaksi. Deri në fillimet e punimeve të takimeve mes redaksive gjegjëse të Prishtinës ky numër shkoi në 23 redaksi.

Nga pikëpamja teknike, fjalësi, në pjesën sunduese, ishte numerizuar dhe alfabetizuar, si dhe propozimet e redaksia e posaçme e Maqedonisë së Veriut, dërguar më 22 gusht 2024 ishin integruar në fjalësit e redaksive të fushave.

Në fund të muajit janar redaksitë e fushave përmbyllën raundet e fundit të takimeve mes redaksive gjegjëse Tiranë-Prishtinë.

Pas dorëzimit të Fjalësve, në vijim, gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, hapet rruga për shqyrtime e vendimmarrje të redaksisë vendore e qendrore dhe më tej për miratimin e fondit themelor të njësive enciklopedike.

Puna shkencore është një aspekt tjetër i performancës së punonjësve shkencorë pranë QBEA-së. Gjatë vitit 2024 ka avancime në tituj e gradë shkencore, ka pjesëmarrje të kënaqshme të tyre në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, kuvende e tryeza shkencore, si dhe botime të këtij lloji.

Janë miratuar si proces botimi dy artikuj për revistat e ASHSH-së, Studia Albanica: "Aspects of the pragmatic status in the book "Briefe an Meine Tote Frau" (author, authorship, genre, the original and its versions); dhe Studime filologjike: Aspekte të statusit pragmatik në veprën Briefe an Meine Tote Frau (autori, autorësia, zhanri, origjinali dhe versionet e tij).

Është në proces e sipër projekti kërkimor në arkivat e Europës dhe të Ballkanit për shkrimtarët e Rilindjes Kombëtare, Pavarësisë dhe të viteve '30-të të shekullit XX (Zagreb, 2024, Krakov 2025 e në vijim) dhe janë publikuar 14 artikuj në gjuhë të huaja të rajonit dhe Europës, pa përfshirë botimet me karakter letrar dhe pjesëmarrjet në antologji.

Propozime për plan pune për vijimin e projekteve madhore në albanologji për vitin 2025

Pas diskutimeve për veprimtaritë e vitit 2025, u përcaktuan edhe objektivat e punës së QBEA-së për vitin 2025 për tri veprat e mëdha: .

1. Fjalori i madh i gjuhës shqipe janar – qershor 2025;
2. Historia e shqiptarëve - janar – qershor 2025
3. Enciklopedia shqiptare - janar – qershor 2025.

Gjatë këtij viti do të kalohet nga faza draft në fazë të konsoliduar të punës për kontratat me autorët, rikonceptim i rolit të redaksive të fushave dhe i drejtuesve të tyre pas procesit të dorëzimit të Fjalësit, koordinimi i punës mes hallkave drejtuese të redaksive të fushave dhe redaksive vendore e qendrore, përgatitja profesionale e punonjësve në lidhje me çështjen e madhësisë së artikujve enciklopedikë dhe përgatitja deri në fund të muajit qershor të Fjalësit të përgjithshëm të Enciklopedisë shqiptare, si libër pune për redaksitë, autorët-shkrues të procesit në vijim, ashtu edhe parapërgatitjen për publikimin online të njësive enciklopedike, pas miratimit.

Detyrë kryesore e redaksive të fushave mbetet përmbyllja dhe dorëzimi i tyre pranë QBEA-së për administrim dhe përpunim teknik.

www.akad.gov.al

Biblioteka Shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Qendra për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor zhvilluan analizën vjetore për vitin 2024 dhe projeksionet për vitin 2025



Më 20 janar 2025 u zhvillua takimi për analizën vjetore të veprimtarisë së Bibliotekës Shkencore të Akademisë (BASH) dhe të Qendrës për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor (QKPISH). Të pranishëm në takim ishin sekretarja shkencore e ASHSH-së akad. Anila Hoda; drejtuesja e bibliotekës dr. Albana Velianj; drejtuesja e QKPISH-së dr. Mirlona Buzo dhe anëtarë të stafit të bibliotekës dhe qendrës.

BASH-i dhe QKPISH-ja në veprimtarinë e tyre u vijnë në ndihmë kërkuesve shkencorë dhe gjithë komunitetit akademik nëpërmjet qasjes pranë informacionit shkencor që ofron biblioteka dhe platformave digjitale që menaxhon qendra.

Drejtuesja e QKPISH-së dr. Mirlona Buzo theksoi se si rezultat i arritjeve gjatë këtij viti ishin dhe 13 marrëveshjet e nënshkruara të bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë dhe bashkitë e rretheve për konfirmimin e anëtarësisë së bibliotekave në rrjetin e përbashkët të digjitalizimit të informacionit **COBISS.AL**.

Sistemi i informacionit **ECRIS.AL** për veprimtaritë kërkimore të kërkuesve shkencorë është zgjeruar me rreth 200 kërkues shkencorë të rinj. Me përfundimin e QKPISH-së dhe përgatitjen e infrastrukturës për funksionimin e saj, janë zhvilluar trajnime profesionale për sistemet dhe platformat online, workshop-e, prezantime dhe takime pune.

QKPISH-ja është pjesëmarrëse si anëtare e Këshillit Rajonal COBISS.Net, që përfaqëson Shqipërinë në këtë rrjet, i cili zhvillon takimet 2 herë në vit. QKPISH-ja, në bashkëpunim me Bibliotekën e Akademisë (BASH), ka koordinuar dhe shpërndarë burime elektronike online me tekst të plotë të bibliotekave anëtare të konsorciumit ndërkombëtar EIFL përmes përgatitjes së formularëve dhe ka kryer trajnime me punonjësit e bibliotekave për përdorimin e këtyre burimeve.

QKPISH-ja menaxhon rrjetin e përbashkët të informacionit COBISS.AL përmes kontrollit të lartë bibliografik për cilësinë e regjistrimeve bibliografike sipas standardeve ndërkombëtare në përgatitjen e informacionit shkencor dhe ndihmën profesionale e teknike për anëtarët dhe përdoruesit e sistemit COBISS.AL (32 000 regjistrime bibliografike për vitin 2024).



Kjo qendër, gjatë këtij viti, prezantoi arritjet në konferencën ndërkombëtare të rrjetit të bibliotekave COBISS 2024, në Slloveni, e shoqëruar me një përfaqësi bibliotekash, përfshirë bibliotekën e ASHSH-së.

Drejtuesja e Bibliotekës së Akademisë së Shkencave, dr. Albana Velianj paraqiti raportin e veprimtarive kryesore të bibliotekës së ASHSH-së për vitin 2024.

Në vitin 2024, me reformimin e Akademisë së Shkencave dhe bashkimin e saj me institutet shkencore, u krye riorganizimi i bibliotekës shkencore të ASH-së. Fondi i bibliotekës shkencore të saj u zgjerua edhe me koleksionet e fondeve përkatëse të

instituteve të historisë, gjuhësisë, letërsisë, arkeologjisë, antropologjisë dhe studimit të artit për përmirësimin e veprimtarisë së saj në funksion të kërkimit, nëpërmjet digjitalizimit të informacionit shkencor dhe shërbimeve të specializuara që ofron biblioteka.

Biblioteka e ASH-së (BASH), në bashkëpunim me Qendrën për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor (QKPISH), kryen studimin e gjendjes së fondeve të bibliotekave të Instituteve të Albanologjisë dhe Arkeologjisë dhe nëpërmjet këtij studimi u evidentuan problematika të shumta që lidhen jo vetëm me gjendjen fizike të ruajtjes së librave në bibliotekë, por dhe me sfidat që dalin për modernizimin e saj nëpërmjet procesit të digjitalizimit.

QKPISH-ja në bashkëpunim me BASH-in realizuan integrimin dhe studimin e fondeve të instituteve shkencore dhe përgatitjen sipas standardeve në katalogun online të bibliotekës së Akademisë së Shkencave në programin COBISS:

Fondi aktual i librave është 153 000 njësi dhe numri i serialeve është 25 000 njësi (të cilat po regjistrohen në programin COBISS). Katalogu online i Bibliotekës së ASH-së shënon gjithsej 33 260 regjistrime bibliografike.

Në fokus të veprimtarisë së Bibliotekës së Akademisë së Shkencave, si një bibliotekë speciale me karakter shkencor, është dhe krijimi i bibliografive shkencore online të akademikëve e kërkuesve; për vitin 2024 u krijuan 4 bibliografi të reja në bashkëpunim me QKPISH-në, të cilat janë përgatitur dhe publikuar online.

Gjithashtu, gjatë vitit, BASH-i në bashkëpunim me QKPISH-në mundësuan digjitalizimin e botimeve shkencore të Akademisë përmes platformës dCOBISS (Digjital Repository COBISS). U realizua përgatitja e teksteve të plota në formë elektronike për t'i integruar në sistemin e digjitalizimit dCOBISS (botime të instituteve), si botimet periodike, përmbledhje konferencash, 9 monografi dhe 11 tituj periodikësh me numrat përkatës sipas viteve.

Për rrjetin e informacionit **COBISS.AL** shënohen statistikat e mëposhtme:

- Regjistrimet në bazën e përbashkët **COBIB.AL**: 158.685 regjistrime bibliografike
- Doktoratura – 4 803 regjistrime bibliografike
- Teza masteri – 3 144 regjistrime bibliografike
- Punime diplomash – 281 regjistrime bibliografike

Në lidhje me objektivat për vitin 2025 analiza u ndal në këto drejtime:

- Zhvillimi i procesit të digjitalizimit të artikujve me tekst të plotë të kërkuesve shkencorë të ASHSH-së përmes platformës dCOBISS (Digjital Repository COBISS), çka do të bëjë të mundur vlerësimin e arritjeve shkencore në platforma ndërkombëtare të publikimeve shkencore.

- Digjitalizimi i fondit të BASH-it në funksion të qasjes së lirë në informacionin shkencor; pajisja me kartat digjitale të anëtarësisë në bibliotekë e të gjithë kërkuesve

shkencorë të ASH-së.



- Vijimi i punës për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë (IAL) dhe bibliotekat publike për anëtarësimin e bibliotekave të tyre në rrjetin COBISS.

- Mundësimi i kualifikimit profesional të punonjësve të bibliotekave për marrjen e licensave për përdorimin e programit COBISS nga specialistë të kualifikuar sipas standardeve ndërkombëtare.

Në përfundim, u theksua se qasja ndaj informacionit shkencor nëpërmjet mundësive që ofrojnë dy njësitë, Biblioteka e ASHSH-së dhe QKPISH-së i shërben gjithë komunitetit akademik, kërkuesve, studiuesve, nëpërmjet bashkëpunimit me gjithë rrjetin e bibliotekave, shkëmbimit të njohurive, ideve, duke krijuar një mjedis bashkëveprimi me teknologjitë më të avancuara për të mundësuar në mënyrë sa më cilësore shpërndarjen e informacionit dhe vlerësimin e arritjeve të kërkuesve shkencorë.

www.akad.gov.al

Qendra e Studimit të Arteve prezantoi "Vjetarin artistik shqiptar"

Qendra e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë prezantoi më 29 janar 2025 "Vjetarin artistik shqiptar", VASH.

Veprimtaria u zhvillua me praninë e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi; zëvendëskryetarit të ASHSH-së akad. Vasil Tole, drejtorit të QSA-së akad. Stefan Çapaliku, studiuesve e artistëve të njohur dhe specialistëve të arkivave nga institucionet e artit.



VASH është një projekt i Qendrës së Studimit të Arteve, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e cila konsiderohet si vepra e parë në llojin e saj në ndihmë kërkuesve shkencorë, pedagogëve, studentëve dhe publikut më të gjerë.

Akad. Stefan Çapaliku, drejtor i QSA-së, çeli veprimtarinë dhe pas fjalës përshëndetëse u ndal së pari në përcaktimin e objektit të punës, mbështetur në pesë aksione bazë, prej nga do të nisë një kontribut sistematik: krijimi i VASH-it; krijimi i Qendrës së Dokumentacionit Artistik; i bibliografisë retrospektive e studimeve mbi artin shqiptar, i enciklopedisë së artit shqiptar, historitë e fushave specifike të artit.

"Të gjitha këto detyra promovojnë idenë e restaurimit të memories dhe rifunksionalizimin e arkivave kulturore."-theksoi akad. Çapaliku.

Ai përmendi rëndësinë e arkivave në ruajtjen e historisë, kulturës dhe identitetit kombëtar, duke përfshirë në mënyrë të veçantë arkivat e institucioneve artistike, të cilat shërbejnë si një burim i pazëvendësueshëm për studime, dokumentim dhe krijimin e

lidhjeve ndërmjet të shkuarës, së tashmes dhe të ardhmes.

Akad. Çapaliku theksoi se dokumentet arkivore ndihmojnë në ruajtjen e një kulture të llogaridhënies, duke siguruar që institucionet dhe individët të jenë të përgjegjshëm për veprimet e tyre.

Së fundi, akad. Çapaliku e vlerësoi krijimin e arkivave si një proces jetik. Ai theksoi se “Arkivat ndihmojnë që historia e artit dhe kulturës të përcillet në mënyrë të saktë dhe autentike, duke shmangur deformimet ose hartimin e kontributit të figurave dhe periudhave të caktuara. Pra, arkivat e institucioneve artistike janë jo vetëm një kujtesë historike dhe një burim edukativ, por edhe një urë që lidh gjeneratat përmes një trashëgimie të pasur dhe frymëzuese artistike.”

Studiuesja e artit dr. Anxhela Cikopano tha se vjelja e arkivave të artit me një paraqitje kronologjike është një punë që duhej të kishte ekzistuar shumë më herët. Ajo vërejtë se ndaj fondit arkivor është treguar pakujdesi dhe duhet të ringrihen dhe t'i rifitojmë arkivat.



Dr. Cikopano prezantoi më pas rrugët që u ndoqën për realizimin e këtij projekti dhe kategoritë dhe burimet e zërave të vjetarit, kategoritë ndërdisiplinore dhe përfshirjen e personaliteteve. Faza e parë e realizimit ka përfshirë grumbullimin e materialeve faktike mbi ngjarjet artistike, kryesisht nga burime arkivore pranë institucioneve qendrore të artit, si dhe të atyre vendore, nga kërkuesit shkencorë të QSA-së në fushat e tyre të studimit: art pamor, kinema, muzikë, teatër, përmes hulumtimeve të drejtpërdrejta, ekspeditave në terren dhe verifikimit të të dhënave me metodën e krahasimit të kryqëzuar të burimeve të ndryshme. Veç paraqitjes

kronologjike të ngjarjeve artistike në format e mësipërme të artit, është menduar të shtohen edhe nënrubrika si në artet pamore: fotografi, pikturë, skulpturë, mix media etj, apo kategori si studime ndërdisiplinore, personalitete, që ndihmojnë edhe më shumë cilindo që ka interes për këto fusha. Pasi foli për vlerat e VASH-it, dr. Çikopano tha se nëpërmjet dhe në funksion të këtij projekti do të ndihmojmë komunitetin e artistëve për të ringritur arkivat dhe njëkohësisht u është bërë një ftesë artistëve dhe drejtuesve të institucioneve dhe ministrive për të nisur një projekt të madh.

Studiuesja dr. Jonida Gashi vuri në dukje se ka ekzistuar mungesa e disiplinës në mbledhjen e arkivave të artit, dhe kjo e bënë VASH-in një projekt me potencial, i cili në kuadër të rrjetëzimit të arkivave, në rastin më të mirë ofron një pasqyrë më të plotë të jetës artistike dhe kulturore.

Akad. Vasil Tole, zëvendëskryetar i ASHSH-së, vlerësoi punën e Qendrës që ka përfshirë në projektet e saj të gjitha disiplinat e artit. Ai theksoi se duhet të nis procesi i hapjes dhe forcimit të bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ato drejtuese.



Gjithashtu akad. Tole premtoi mbështetjen e Akademisë së Shkencave dhe bashkëpunim më të ngushtë me Komisionin e Arteve që ai drejton. Në fund akad. Tole shprehu vlerësimin për Vjetarin dhe shpresën që në vijim të marrë karakter enciklopedik.

Drejtues të arkivave të teatrove kombëtarë në Shkodër, Elbasan, Vlorë, diskutuan për problematikat e institucioneve.

Pas diskutimeve, Durim Taçi, përgatitësi për botim i projektit, foli për

perspektivën e një botimi më të plotë, i cili do të marrë edhe përmasën divulgative për t'u përdorur më gjerësisht.

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e përgëzoi grupin e punës së këtij projekti për iniciativën dhe arritjet e deritanishme dhe u shpreh për perspektivën e lidhjes së marrëveshjeve institucionale me qendrat arkivore. Ai theksoi se Qendra e Studimit të Artit duhet të lidhet edhe me Qendrën e Botimeve Enciklopedike, sepse në realizimin e plotë të këtij projekti, "Vjetari artistik shqiptar" do të marrë karakterin e një vepre të drejtimit enciklopedik. Në mbyllje të fjalës së tij, akad. Gjinushi premtoi se bashkëpunimi me arkivat do të institucionalizohet dhe do t'i jepet qendrës një drejtim bashkëpunues në perspektivën e finalizimit të një projekti më madhor.



VASH-i ka statusin e një udhëzuesi dinamik, që do të pasurohet në mënyrë sistematike nga kontributi i të gjithëve, duke i përfshirë të gjitha institucionet kulturore dhe artistike, kudo që të ndodhen: brenda kufijve të territorit të Shqipërisë, në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut, por edhe në diasporë, me synimin për ta pasuruar me të dhëna të reja.

www.akad.gov.al

Qendra e Kërkimeve në Bioteknologji dhe Gjenetikë prezantoi kërkimet shkencore të projektit “Sëmundjet autoimune të sistemit nervor: algoritmet diagnostike dhe korelacionet imunogjenetike”



Në datën 16 janar 2025 Qendra e Kërkimeve në Bioteknologji dhe Gjenetikë (QKBGJ), pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, realizoi workshop-in “Sëmundjet autoimune të sistemit nervor: algoritmet diagnostike dhe korelacionet imunogjenetike” për të paraqitur të dhënat paraprake e mundësitë e zbatimit të rezultateve të këtij projekti të përpunuara deri më tani.

Veprimtaria u organizua me mbështetjen dhe bashkëpunimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), si dhe të Shërbimeve Universitare të Neurologjisë dhe Pediatriisë të QSUNT-së.

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në fjalën e tij përshëndetëse u uroi mirëseardhjen përzemërsisht përfaqësuesve të punonjësve kërkimorë shkencorë, mjekëve e specialistë të lartë në fushën e mjekësisë dhe të bioteknologjisë. Ai vuri në dukje se Qendra e Kërkimeve në Bioteknologji dhe Gjenetikë u ngrit me mjaft mund si një përvojë e parë e Akademisë së Shkencave për të ngritur qendra të reja të kërkimit, fillimisht me buxhete tepër modeste. Kryetari i ASHSH-së theksoi nevojën e investimeve në fushën e mjekësisë, në të cilën teknologjitë e reja, arrijtjet më të fundit të shkencës janë më se të domosdoshme për rritjen e cilësisë në kërkimin shkencor, për të cilin është dashur të thyhen disa koncepte duke treguar se

Akademia e Shkencave, strukturat e saj nuk bëjnë shkencë për shkencë, por shkencë në dobi të ekonomisë, në dobi të shoqërisë, pra shkencë të zbatueshme dhe është pikërisht kjo njësi e përhershme, njësi autonome pranë Akademisë së Shkencave, që menjëherë pas marrjes së statusit ka filluar për të afruar zbatime të prekshme në fushën e mjekësisë.



Kryetari i Akademisë së Shkencave vlerësoi bashkëpunimin e ASHSH-së me Qendrën Spitalore Universitare. Është preferuar dhe është vlerësuar nga ASHSH-ja që QKBGJ-ja të jetë pranë Qendrës Spitalore pikërisht për të siguruar këtë bashkëpunim të domosdoshëm dhe për të treguar që synimi është zbatimi i metodave të reja dhe të kërkimit drejtpërdrejtë në dobi të pacientëve.

Akad. Gjinushi u shpreh më tej për një bashkëpunim e koordinim të të gjitha potencialeve shkencore në fushën e mjekësisë, biologjisë në tërësi, pranë Universitetit të Tiranës, Universitetit Bujqësor, Qendrës Spitalore, Universitetit të Mjekësisë etj. Për të siguruar këtë bashkëpunim pranë QKBGJ-së me 8 anëtarë ka një bord shkencor me përfaqësues të këtyre institucioneve.

Në fund të fjalës së tij akad. Gjinushi tha se organizimi i përbashkët i këtyre workshop-eve, konferencave, në vazhdimësi tregon dhe mirëpritjen nga ana e këtyre institucioneve për të bashkëpunuar dhe shprehu edhe njëherë falënderimet për risitë e kërkimit shkencor të këtij workshop-i.

Akad. Genc Sulçebe falënderoi akad. Gjinushin dhe u shpreh se është meritë e

Kryetarit që u ngrit QKBGJ-ja dhe është një risi e sfidë në implementimin e punës kërkimore.

Workshop-i u drejtua nga akad. Genc Sulçebe dhe prof. Jera Kruja.

Prof. Jera Kruja falënderoi kryesinë e ASHSH-së dhe drejtuesin e QKBGJ-së për bashkëpunimin dhe u shpreh se studimi për imunologjinë në Qendrën e Shërbimeve Universitare të Neurologjisë dhe Pediatriisë të QSUNT-së mungonte, dhe ky studim me kontributin e ASHSH-së dhe të akad. Sulçebeut tashmë është kompletuar.



Më pas vijoi prezantimi i studimit pilot “Sëmundjet neurologjike dhe imunologjia” nga prof. Jera Kruja, i hartuar në bashkëpunim me Altin Kuqon, Ariola Verlaku, Jusri Kajoshin, Emili Mara (QSUNT dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë).

Akad. Sulçebe prezantoi kërkimin shkencor “Mekanizmat imune në sëmundjet e sistemit nervor: Roli i markuesve imunologjikë dhe gjenetikë”, hartuar në bashkëpunim me Erkena Shytin, Donika Kasëmi-Taragjinin, Margarita Kurtin, Zamira Yllin

(Akademia e Shkencave e Shqipërisë, QSUNT, Universiteti i Mjekësisë).

Prof. Margarita Kurti prezantoi studimin “Autoantittrupat në sëmundjet autoimune të sistemit nervor”, hartuar në bashkëpunim me Genc Sulçebe, Donika Kasëmi-Taragjini, Erkena Shyti, Aida Bushati, Gjeorgjina Lito-Kuli, Zamira Ylli, Jera Kruja (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, QSUNT, Universiteti i Mjekësisë).

Aida Bushati, QSUNT dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, prezantoi studimin “Encefalitet autoimune në moshat pediatrike dhe Gjeorgjina Kuli-Lito, QSUNT dhe Universiteti i Mjekësisë, Tiranë prezantoi studimin “Encefalitet virale dhe autoimune: Entitete të ndara apo të ndërlidhura?”.

Në fund të këtij wokshopi, u paraqitën rezultatet dhe konkluzionet e projektit kërkimor “Studimi i rolit diagnostikues të autoantittrupave specifike në sëmundjet e sistemit nervor me mekanizma imune” të realizuar me mbështetjen e AKKSHI-it dhe ASHSH-së.

Objektivat kryesore të këtij projekti janë implementimi i ekzaminimeve të reja diagnostikuese në sëmundjet autoimune të sistemit nervor si dhe studimi i markuesve gjenetikë në këto sëmundje.

Në zbatim të tij, në QKBGJ u zbatuan për herë të parë në vendin tonë ekzaminime të reja laboratorike që ndihmojnë në mënyrë të rëndësishme në përmirësimin e kujdesit shëndetësor të disa sëmundjeve të sistemit nervor me natyrë autoimune, siç janë Skleroza multiple, Neuromieliti optik, Miastenia e grave, Encefaliti autoimun apo Polineuropatite periferike. Diagnoza e saktë dhe sa më e hershme e sëmundjeve të mësipërme bën të mundur dhe studimin e markuesve gjenetikë të këtyre sëmundjeve autoimune. Këta markues, që janë specifike në çdo popullatë mundësojnë një mjekësi më të personalizuar duke mundësuar parashikimin e shfaqjes klinike të këtyre patologjive, si dhe njohjen me të mirë të prognozës së sëmundjes.

Nga të dhënat paraprake, në popullatën shqiptare janë identifikuar pesë alele specifike të sistemit gjenetik HLA që janë favorizuese për Sklerozën Multiple dhe gjashtë të tjerë që kanë efekt mbrojtës nga kjo sëmundje pasi hasen shumë më pak ose aspak në individët e sëmurë në krahasim me popullatën e shëndoshë.

Nga ky workshop u konkludua se rezultatet e deritanishme të arritura në projektin kërkimor “Studimi i rolit diagnostikues të autoantittrupave specifike në sëmundjet e sistemit nervor me mekanizma imune” i mbështetur nga AKKSHI dhe ASHSH-ja nevojiten të konsolidohen më tej, duke u futur në mënyrë të qëndrueshme në praktikën klinike.

Gjithashtu, në workshop u nënvizua se eksperiencia e fituar në këtë studim duhet të shtrihet në studimin e markuesve gjenetikë edhe të sëmundjeve të tjera me karakter imunologjik.

www.akad.gov.al

U zhvillua analiza e punës mbi veprimtarinë e njësisë së përkohshme të kërkim-studimit në fushën e energjisë së ripërtëritshme për vitin 2024



U zhvillua analiza e punës mbi veprimtarinë e njësisë së përkohshme të kërkim-studimit në fushën e energjisë së ripërtëritshme për vitin 2024 dhe projeksionet për vitin 2025.

Në takim ishin të pranishëm: akad. Ilirjan Malollari, drejtues i Njësisë së përkohshme të kërkim-studimit për energji të ripërtëritshme (ASHSH); akad. Neki Frashëri, Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike (ASHSH); akad. Besnik Baraj (ASHSH); prof. asoc. Nevton Kodhelaj (UPT); prof. asoc. dr. Partizan Malkaj (UPT), prof. dr. Petrit Zorba (Instituti i Gjeoshkencave, UPT), Artan Leskoviku (AKBN), prof. asoc. dr. Driada Mitrushi (UPT).

Akad. Malollari paraqiti raportin e punës dhe të veprimtarisë së Njësisë së përkohshme të kërkim-studimit në fushën e energjisë së ripërtëritshme për vitin 2024.

Njësia e përkohshme e kërkim-studimit për energji të ripërtëritshme (NPKSER) është themeluar me vendimin nr. 71, datë 13.12.2021, të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, me qëllimin themelor për zhvillimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, duke përfshirë energjinë hidro, diellore, erën dhe biomasën.

Në analizë akad. Malollari tha se gjatë këtij viti është bërë identifikimi i mundësive për njohjen dhe evidentimin e teknologjive ekzistuese dhe zhvillimin e teknologjive të reja në fushën e energjive të ripërtëritshme dhe përdorimin e tyre në praktikë. Janë hartuar dhe janë zhvilluar projekte kërkimore dhe studime të detajuara

në fushën e energjive të ripërtëritshme. Janë arritur bashkëpunimet me institucione të tjera kërkimore në nivel vendi dhe ndërkombëtar për të ndarë njohuri dhe përvoja në fushën e energjive të ripërtëritshme.

Janë realizuar 15 studime mbi potencialin e energjisë hidro, diellore, dhe erës, biomasës dhe gjeotermike. Këto studime përfshijnë analiza teknike dhe ekonomike për implementimin e projekteve. Njësia ka zhvilluar projektin pilot për testimin e teknologjive të reja. Gjithashtu një rezultat i punës gjatë këtij viti ka qenë organizimi i tri konferencave shkencore për promovimin e kërkimeve dhe rezultateve. Janë organizuar (dy) seminare, një konferencë, dhe një forum shkencor dhe trajnime për të rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë në fushën e energjive të ripërtëritshme. Janë publikuar rezultate të kërkimeve dhe studimeve (25) në konferenca të huaja dhe të vendit dhe publikime në revista shkencore.



Njësia ka dhënë kontribut në shqyrtimin e "strategjisë për adoptimin e energjisë së rinovueshme në Shqipëri", ku përfshihen çështje si: Panorama aktuale e energjisë në Shqipëri; Identifikimi i burimeve të rinovueshme të energjisë; Korniza e politikave dhe masat rregullative; Zhvillimi i infrastrukturës dhe integrimi i rrjetit; Konsideratat financiare dhe bashkëpunimi ndërkombëtar; Kalimi në një ekonomi të energjisë së rinovueshme etj .

Gjatë prezantimit të raportit vjetor u diskutuan dhe çështje si analiza krahasuese e burimeve të rinovueshme të energjisë dhe krahasimi i efikasitetit dhe kostove të burimeve të ndryshme të rinovueshme.

Anëtarët e Njesisë vlerësuan se kalimi në energjinë e rinovueshme është një hap

kritik drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe luftimit të ndryshimeve klimatike. Shqipëria ka një mundësi unike për të shfrytëzuar burimet e saj të bollshme të energjisë së rinovueshme dhe për të krijuar një të ardhme më të gjelbër.

Për vitin 2025, Njësia e përkohshme e kërkim-studimit në fushën e energjisë së ripërtëritshme ka ndërmarrë objektiva që të kontribuojë në zhvillimin dhe promovimin e burimeve të energjisë së rinovueshme në Shqipëri dhe të fokusohet në kërkimin shkencor dhe aplikimin e teknologjive të reja që ndihmojnë në përdorimin efikas të energjisë.

Kjo njësi në fushën e energjisë së ripërtëritshme ka një rol kyç në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit energjetik në Shqipëri. Me mbështetje të mjaftueshme financiare dhe politike, ajo mund të kontribuojë ndjeshëm në arritjen e objektivave kombëtare për energjinë rinovueshme.

www.akad.gov.al

U zhvillua mbledhja e Komisionit fizikë-kimi për analizën vjetore të punës për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025



Më 14 janar 2025 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua mbledhja e Komisionit fizikë-kimi për analizën vjetore të punës për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025.

Ishin të pranishëm kryetari i këtij komisioni akad. emeritus Floran Vila; kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad. Neki Frashëri (online); akad. Ilirjan Malollari; akad. asoc. Besnik Baraj; prof. dr. Rozana Troja; prof. dr. Petrit Zorba; prof. dr. Elida Bylyku; prof. dr. Partizan Malkaj; prof. dr. Fatos Ylli; prof. dr. Elda Marku; dr. Shaniko Allajbeu; akad. emeritus Dhimitër Haxhimihali (online); prof. asoc. dr. Florian Mandija (online); akad. Mimoza Hafizi (online).

Akad. emeritus Floran Vila paraqiti raportin e analizës vjetore për vitin 2024. Ai theksoi se ky vit ishte i pari që shënoi fillimin e fazës së dytë të reformës, që përfshin periudhën (2024-2027). Ai tha se në vitin 2024 Komisioni i fizikë-kimisë ka realizuar 4 mbledhje, ku janë analizuar synimet themelore të vitit të parë (2024) të fazës së dytë të reformës (2023-2027 dhe mbledhje të tjera për forcimin e rolit të këtij komisioni në projektet që propozon ASHSH-ja. Komisioni i fizik-kimisë është zgjeruar me 3 anëtarë të rinj.

Më tej akad. emeritus Vila foli për strategjitë e ndjekura në bashkëpunim me Asamblenë dhe Seksionin e Shkencave Natyrore e Teknike të ASHSH-së me Qendrën

NanoAlb, Njësinë “Pasuritë ujore” dhe Institutin Kombëtar të Fizikës (IKF), që veprimtaritë e tyre të zhvillohen në nivel kombëtar, me anë të konferencave shkencore, seminareve, shkollave verore e dimërore të fizikës, etj.

Në mbledhjet e takimet e zhvilluara gjatë vitit 2024 Komisioni është ndalur në problemin e mbylljes së disa degëve të shkencave ekzakte, për të cilin është kryer me një grup pune takimi me temën: “Mendime dhe sugjerime lidhur me zhvillimet imediate të programeve të shkencave bazë, fizikë, kimi, biologji, matematikë”. Materiali i përgatitur prej tyre u shqyrtua dhe miratua në mbledhjen pasuese. Komisioni e konsideroi rënien e aplikantëve në shkencat bazë kimi, fizikë, biologji e matematikë për vitin akademik 2023-2024 (por edhe për 2 vitet paraardhëse) si një problematikë madhore për vendin dhe zhvillimin e tij të qëndrueshëm, përfshi këtu edhe proceset e integritetit europian.



Disa nga veprimtaritë kryesore të realizuara nga komisioni gjatë vitit 2024 janë: Kryerja e studimit “Mendime për zhvillimet imediate të Fizikës dhe Kimisë në nivelin universitar”; vlerësimi i programit shkencor dhe objektivave të qendrës NanoAlb dhe dy njësive (pasuritë ujore dhe energjia e rinovueshme); Java e shkencës në fizikë dhe veprimtaria përmbyllëse e Younivers. (22-26 janar 2024); Forumi shkencor mbi rolin e gruas në shkencë “Gratë shqiptare në nanoteknologji 8 mars 2024; Konferenca e Ndërkombëtare mbi mjedisin, klimën dhe shkencat e tokës (Bashkëpunim me universitetin e Tiranës) (9-10 maj 2024); Workshop-i shkencor i organizuar nga njësia studimore "Pasuritë Ujore" me temë “Maksimizimi i veprimtarisë së komunitetit shkencor për t’ju përgjigjur sfidave të menaxhimit të integruar të ujerave”. (29 shkurt

2024); Konferenca shkencore ndërkombëtare me temë "Ndryshimet klimaterike dhe ndikimi i tyre në disponueshmërinë e cilësinë e ujit (27-28 maj, bashkëpunim me ASHAK-un); Workshop-i shkencor për projektet NanoAlb dhe masterin në nanoteknologji (25 qershor 2024); Workshopi i 3-të me temë "Shkenca e Nanoteknologjisë takon industrinë: Krijimi i bashkëpunimeve" (26 qershor 2024); Java e Shkencës (Science Week 2024); simpoziumi shkencor "Ekonomia riqarkulluese në ndërtim" (15 tetor 2024); Konferenca shkencore ndërkombëtare NanoBalkan 2024 (28 tetor-1 nëntor 2024); Ligjërata shkencore-popullarizuese (Open days); Përmbyllja e konkursit ndërkombëtar me video Younivers 2024 për frankofonët e rinj (12 nëntor 2024); Forumi vjetor i NanoAlb (16 dhjetor 2024); Forumi QUARTZ-II (17 dhjetor 2024). Pas raportit vjetor, u propozuan dhe u diskutuan veprimtaritë e parashikuara për vitin 2025. Ndër to një vend të veçantë zuri diskutimi i forumit "Shkolla e doktoraturës në sistemin universitar (fizikë - kimi)" si një çështje shumë e rëndësishme për fushat e shkencës ku doktorantët janë studiuesit, profesorët dhe shkencëtarët e ardhshëm. Komisioni ngriti një grup pune për këtë tematikë. Anëtarët e Komisionit fizikë-kimi premtuan mbështetjen e plotë të aktiviteteve të planifikuara nga Instituti Kombëtar i Fizikës, që në fokus të veçantë do të kenë teknologjinë kuantike, dhe të veprimtaritë e planifikuara nga njësitë: NanoAlb, Energjia e rinovueshme dhe Pasuritë ujore.

U mbajt workshop-i i projektit “Përdorimi i mjeteve molekulare për detektimin e hershëm të infektimit nga Fusarium & Vlerësimin e tolerancës ndaj faktorëve abiotikë në kultivarë lokalë të grurit (*Triticum aestivum* L.)”



Më 16 janar 2025 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, u mbajt workshop-i i projektit “Përdorimi i mjeteve molekulare për detektimin e hershëm të infektimit nga Fusarium & Vlerësimin e tolerancës ndaj faktorëve abiotikë në kultivarë lokalë të grurit (*Triticum aestivum* L.)”, i financuar nga AKKSHI dhe realizuar në bashkëpunim ndërmjet Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN-së, UT-së, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, UBT-së, dhe ISUV-së.

Aktiviteti u zhvillua me pjesëmarrjen e prof. dr. Enika Abazi, drejtoreshë e Qendrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në Akademinë e Shkencave, dhe përfaqësuesve nga AKKSHI.

Gjatë prezantimit, përveç anëtarëve të projektit, ishin të ftuar nga QTTB-ja e Lushnjës dhe Universiteti “Fan Noli”, Korçë, kolegë nga institucione të tjera dhe studentë të programeve master i shkencave dhe master profesional pranë Departamentit të Bioteknologjisë, FSHN.

Workshop-i u drejtua nga prof. dr. Ariola Bacu - drejtuese e projektit. Fillimisht ajo bëri prezantimin e objektivave të projektit dhe të skemës metodologjike të ndjekur

për realizimin e tij. Prof. dr. Bacu theksoi se qëllimi i këtij projekti është dedektimi i hershëm i infeksionit nga Fusarium dhe vlerësimi i tolerancës së kultivarëve lokalë, etj.

Seanca e parë nisi me prezantimin e kërimit shkencor me temë “Detektimi i infeksionit fusarium-metodologji molekulare e konvencionale”. Krisida Ciko dhe Suzana Kola paraqitën metodologjitë për përcaktimin e mykotoksinave në farat e grurit dhe validimin e metodave të ekstraktimit dhe matjes së tyre. Më tej, prof. dr. Ariola Bacu dhe Renis Maci paraqitën kërkimet rreth përdorimit të TaqMan qPCR për detektimin e FHB në nivel gjinie dhe speciesh dhe për krahasimin e efikasitetit të protokolleve të aplikuara, si dhe rezultatet e projektit.

Linda Luarasi paraqiti kërkimin shkencor për përdorimin e mikro-morfologjisë dhe karakteristikave strukturore të kolonive të Fusarium si mjet për identifikimin e infeksionit në farat e grunjërave, si dhe rezultate të projektit. Robert Damo paraqiti studimin me temë “Monitorimi i hershëm i fusariozes (Fusarium spp) me anë të informacionit spektral të gjetheve”.



Në seancën e dytë u prezantua kërkiti shkencor me temë: “Vlerësimi i tolerancës së kultivarëve lokalë të grunjërave ndaj faktorëve abiotikë”

Prof. dr. Vjollca Ibro dhe prof. dr. Ariola Bacu në bashkëpunim me Enia Ramën dhe Eniada Recin paraqitën kërkimet shkencore për dallimet në mbirshmëri dhe

tolerancën ndaj thatësirës të disa kultivarëve të grurit të butë (*T. aestivum* L.) bazuar në parametra morfo-fiziologjikë. Eniada Reci, prof.dr. Ariola Bacu, Enia Rama paraqitën studimin për parametrat molekularë, biokimikë dhe fiziologjikë të cilat ndihmojnë në klasifikimin e nivelit të tolerancës së grunjërave ndaj stresit të temperaturës së lartë.

Më tej, prof. dr. Ariola Bacu, prof. Vjollca Ibro, Krisida Ciko, Eniada Reci, Deana Xhuli, paraqitën studimin për kujtesën epigjenetike të grunjërave ndaj stresit të përsëritur të temperaturës së lartë, e cila qartëson një tjetër dimension të tolerancës në nivel kultivarësh. Stela Papa, prof. Ariola Bacu, dr. Christos Bazakos, dr. Chrysanthi Polychroniadou paraqitën kërkimet me temë “Metabolomics në shërbim të të kuptuarit të ndryshimeve në metabolitët primarë dhe sekondarë të grunjërave në kushtet e thatësirës.”



Së fundi, u paraqit studimi për ndikimin e infeksionit *Fusarium* në rezistencën e disa kultivarëve të grunjërave ndaj shokut termik, bazuar në të dhëna molekulare, biokimike, fiziologjike dhe morfometrike nga Krisida Ciko, prof. dr. Ariola Bacu, Eniada Reci e Deana Xhuli.

Në përfundim të këtij prezantimi, prof. Ariola Bacu bëri një përmbledhje të rezultateve të matshme të projektit: publikime, raporte, prezantime në veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, udhëheqje të studentëve, etj.

www.akad.gov.al

U zhvillua takimi informues mbi thirrjet për projektet e financuara nga Agjencia Kombëtare për Kërkimin dhe Zhvillimin e Shkencës dhe Inovacionit

Më 8 janar 2024 Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Kërkimin dhe Zhvillimin e Shkencës dhe Inovacionit (AKKSHI) organizoi një takim informues mbi thirrjet për projektet që do të financohen për vitin 2025.

Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe institucioneve kërkimore, përfshirë akad. Vasil Tole, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; dr. Marsela Robo, drejtoreshë e Programeve Kombëtare në AKKSHI dhe prof. dr. Enika Abazi, drejtoreshë e Qendrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në Akademinë e Shkencave. Gjithashtu, ishin të pranishëm dhe drejtuesit e seksioneve, instituteve dhe qendrave kërkimore shkencore pranë ASHSH-së.

Ky takim u organizua në kuadër të thirrjeve për projekte që do të financohen nga AKKSHI për vitin 2025.

Akad. Vasil Tole përshëndeti të pranishmit në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe theksoi rëndësinë e përhapjes së kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizmit, si dhe nevojën për bashkëpunim dhe përfshirje të ASHSH-së në këto projekte.



Dr. Enika Abazi, drejtoresha e QPKKSH-it, informoi se AKKSHI ka financuar 24 projekte të rëndësishme në fushat e kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit që rrjedhin nga ASHSH-ja. Për periudhën 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025, AKKSHI ka ndarë një buxhet prej 46,137,532 lekësh për financimin e projekteve, ndërsa ASHSH-ja, në bashkëpunim me institucione të tjera, ka kontribuar me një shumë prej 1,452,768 lekësh për bashkëfinancimin e këtyre projekteve. QPKKSH-ja ka dërguar materiale shpjeguese për Programet Kombëtare të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI) si dhe për Projekte të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH) në kuadër të programeve kombëtare për vitin 2025.



Drejtoresha e AKKSHI-t, dr. Robo, prezantoi thirrjet për aplikim për projekte të ndryshme në vitin 2025, duke përfshirë Programet Kombëtare për Teknologjitë e Inovacionit (PTI) dhe Programet Kombëtare për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZH). Ajo theksoi se në projektet që do të financohen për vitin 2025, partneritetet do të kenë një rëndësi të veçantë dhe do të kenë prioritet në procesin e vlerësimit të aplikacioneve. Kjo do të inkurajojë bashkëpunimin midis institucioneve akademike dhe organizatave të ndryshme në vend. AKKSHI ka punuar për të afruar standardet e kërkesave të projekteve me ato të Bashkimit Europian, duke synuar rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të projekteve të financuara. Në procesin e vlerësimit do të merret parasysh cilësia e produkteve të projektit, si dhe publikimi i rezultateve të studimeve në revista të indeksuara, për të rritur transparencën dhe promovuar rezultatet e kërkimeve.

Gjatë takimit, dr. Robo dhe prof. dr. Enika Abazi ndanë njohuri mbi thirrjet për projektet e AKKSHI-t dhe theksuan rëndësinë e avancimit të bashkëpunimit midis institucioneve, hulumtuesve dhe profesionistëve të tjerë në këtë fushë.



Në vijim, u zhvillua një diskutim me pjesëmarrësit mbi kriteret e vlerësimit, fushat prioritare, rëndësinë e cilësisë së produkteve të projektit dhe publikimin e rezultateve të studimeve në revista të indeksuara. Pjesëmarrësit shprehën interes për të mësuar më shumë rreth mundësive të financimit, projekteve të reja dhe praktikave më të mira për aplikime cilësore.

www.akad.gov.al

U zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare me temën “Thirre vendin tënd! Hapësira: kujtesë gjuhësore, historike dhe antropologjike”

Instituti i Antropologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi një konferencë shkencore në kuadër të projektit “Radhori i toponomastikës së Shqipërisë” (financuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit - AKKSHI) të drejtuar nga dr. Ledi Shamku.



Veprimtaria u zhvillua me pjesëmarrjen e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi dhe anëtarëve të tjerë të kryesisë; drejtorit të Institutit të Antropologjisë prof. asoc. dr. Olsi Lelaj; drejtorit të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë akad. Valter Memisha; dr. Marsela Robo, drejtoreshë e Programeve Kombëtare në AKKSHI, si dhe përfaqësuesve të tjerë nga institucionet bashkëpunuese për këtë projekt.

Drejtuesja e projektit, dr. Ledi Shamku, në fjalën e saj përshëndetëse tha se për këtë konferencë u koordinua me Akademinë e Shkencave që të lihej në një ditë të shënuar, si 17 Janari, dita kur Heroi Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu la botën e të gjallëve: pushoi së qeni roja jonë tokësore, për të qenë roja jonë qiellore në përjetësi. Kjo

datë përkon edhe me jubileun e lindjes së Gjergj Kastriotit (1405).

Konferenca u çel me një incipit muzikor nga opera “Skënderbeu, zot i Arbrit” e kompozitorit akad. Vasil Tole.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi në fjalën përshëndetëse shprehu falënderimet e tij për mbështetjen e këtij projekti nga AKKSHI dhe për drejtuesit e bashkëpunëtorët.

Ai vlerësoi trendin rritës të fondeve nga qeveria për projektet shkencore dhe theksoi se të dyja institucionet, ASHSH-ja dhe AKKSHI, kanë synime e qëllime të njëjta. Akademia e Shkencave duhet të jetë nxitësja, organizuesja kryesore për të ideuar dhe për të ndërmarrë projekte të caktuara dhe AKKSHI, si organi investues i projekteve, ka si qëllim të bëjë seleksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre projekteve, -tha akad. Gjinushi.



Drejtori i Institutit të Antropologjisë, prof. asoc. dr. Olsi Lelaj, në fjalën e tij përshëndetëse vuri në dukje punën e bërë gjatë dy vjetëve të realizmit të këtij projekti, për të cilin një rol të madh kanë luajtur kërkimet në terren. Ai e vlerësoi projektin si një shtyllë kurrizore brenda IA-së, që u mbështet dhe vijon të mbështetet nga ASHSH-ja. Projektet kërkimore të këtij kalibri nuk braktisen në që ato mbyllen, por ato krijojnë një infrastrukturë të brendshme dhe një organicitet të rëndësishëm për të vijuar punën në vitet e ardhshme. Dr. Shamku ka hedhur tharmin e një projekti që do të vijojë edhe këtë vit, duke zgjeruar stafet tona dhe duke krijuar ura bashkëpunimi me kërkuesit shkencorë dhe me institucionet shkencore, -tha drejtori i Institutit të Antropologjisë.



Më tej, prof. asoc. dr. Lelaj argumentoi se ky projekt çel një shteg të ri brenda studimeve antropologjike në Shqipëri, atë të antropologjisë gjuhësore dhe si përfaqësues i Institutit të Antropologjisë i propozoi Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë miratimin e çeljes së Sektorit të Antropologjisë Gjuhësore në strukturën e Institutit të Antropologjisë.

Akad. Valter Memisha vlerësoi punën e bërë nga organizatorët dhe mbështetësit e veprimtarisë. Ai vuri në dukje se ky projekt i miratuar në departamentet e IGJL-së dhe të ASHSH-së është një shtysë për projekte të tjera të tipologjive me vlerë kombëtare.



Pas fjalëve përshëndetëse, dr. Ledi Shamku bëri prezantimin e projektit: Fillimisht ajo bëri një përshkrim të materialit arkivor që ka shërbyer në realizmin e këtij projekti.

Dr. Shamku tha se në arkivat e Akademisë së Shkencave është trashëguar një skedar me rreth 250 mijë skeda toponomastike (emërtesa vendesh në mbarë Shqipërinë), të vjela e të hartuara më së shumti në vitet '50-'80 nga punonjës shkencorë dhe ekspedita të posaçme (Zojzi, Haxhihasani, Domi, Totoni etj.), si edhe nga një aksion i madh kombëtar i dikurshëm, i cili përfshiu edhe mësuesit. Ky trashëgim sot është tejet i çmuar për disa arsye, të cilat përmbledhtazi po i renditim më poshtë:

Shqipja nuk e ka ende një Fjalor Kombëtar të Toponomastikës (e as një radhua apo skedar të posaçëm të kësaj disipline);

Punë të tilla vjeljeje janë afërmendsh fryt i një tjetër situatë politike, ekonomike, kulturore e sociale, pasi sot, në kushtet e ekonomisë së tregut, do të kishin një kosto tejet të lartë;

Bumi kaotik i lëvizjeve demografike që shpërtheu pas viteve '90 mund t'i bëjë të përfshirë sot e më tej mjaft zona apo areale të Shqipërisë që po shkojnë drejt shpopullimit ose zëvendësimit të popullatave (më periferiket drejt zonave më pak periferike). Vetë mbipopullimi i arealeve kryesore urbane së bashku me eksodin e shtuar janë argumente që mbështesin drojën dhe dyshimet tona.



Mangësia e historicizimit të lëvizjeve demografike, rojave tona, si rrjedhojë e dokumentimeve të pakta shkrimore, kanë lënë zbrazëti të ndjeshme sa i takon lëvizjes

dhe shtegtimin të fiseve. Mirëpo, shpesh toponimet janë shndërruar në mbiemra trungjesh familjare (patronime) apo emrat e fiseve janë shndërruar në toponime. Ndjekja e plotë e këtyre zinxhirëve toponomastikë mund të vlejë jo vetë për gjuhëtarët, por edhe për historianët e antropologët e kulturës shqiptare.

Për këtë arsye i mëshoj faktit që një trashëgimi e tillë skedash duhet digjitalizuar sa më parë për ta shndërruar atë në një material të përdorshëm (e të aksesueshëm). Për të mos cenuar aspak cilësinë e punës, është menduar që bri radhitjes të vendoset edhe skeda (imazhi i skedës) e dorëshkruar, në mënyrë që t'i paraprihet ndonjë lapsusi në radhitje. E po ashtu, është dakordësuar me ASIG-un për të hedhur në një hartë digjitale sinjalizuese çdo toponim që do të zbardhet nga skedat e që do të jetë pjesë e skedarit tonë elektronik. Në këtë mënyrë do të lokalizohet qartë vendndodhja e çdo toponimi a mikrotoponimi. Së fundi – dhe jo më pak e rëndësishme – është menduar që të verifikohet në terren edhe shqiptimi autokton i secilit toponim, duke qenë se dyshohet që për vetë kohën kur u hartua dhe trysninë e re të kodit standard, mund të ketë pasur edhe normalizime (lexo: deformime) të autenticitetit të toponimeve, prirje të verifikuara edhe nga hartueset e këtij projekti.

Më tej, dr. Shamku foli për kontributet specifike që sjell projekti në shkencat fundamentale dhe/ose të aplikuar:

Më së pari, ajo theksoi se në fushën e gjuhësisë realizimi i këtij projekti mundëson shfrytëzimin e skedarit të toponomastikës, i cili, në gjendjen që ndodhet, është thuajse i papërdorshëm. Në kushtet e një gjuhe e kulture të dokumentuar tejte vonë me shkrim, toponimet (edhe sipas Çabejt) janë sot burimi kryesor dokumentues i gjuhësisë historike. Ndërsa vëzhgimi i gjurmës së tyre zanore burimore, me një kampion sociolinguistik ndërbreznor të ndërtuar in loco, shërben edhe si matje e përparimit të shqipes letrare (skedat aktuale janë regjistruar të letrarizuara).

Realizimi i këtij projekti do t'u vlejë shumë edhe historianëve, demografëve apo antropologëve, për të rindërtuar përmes tyre edhe shtegtimet e fiseve, migrimet e brendshme apo trans-humancat.

Elementi etnografik i shtuar nga ne në projekt, pra vjelja në terren e gjithë humusit historiko-popullor, gojëdhanor, mitologjik a proverbial, që lidhet me vetë toponimin a me komunitetin e banorëve të atyshëm, është material fthillues jo vetëm për vetë toponimin, por edhe për historikun pjesor të asaj zone, me synim turistifikimin real, vleror e të qëndrueshëm të tij. Kjo vlen qoftë për miniguidat turistike e qoftë për administratën lokale në rigjallërimin a organizimin e kretimeve komunitare si vlerë paraqitëse kulturore e zonës. Sikundër u vlen edhe studimeve etnografike e historike, e po ashtu edhe zbulesave arkeologjike, gjithë duke ndjekur shtegun e propozuar nga Nikollë Gazulli, i cili sugjeron që në kesi punësh të ndiqet pikëprerja mes emërimit, mitit e historisë.

E fundit, por po aq e rëndësishme mbetet realizimi i këtij projekti në fushën e shkencave të botanikës a të ekosistemit. Shpesh del se toponimet janë fitonime (emra drurësh a shkurresh), të tilla si: Blinisht, Kashnjet, Shkozet, Prrenjas etj. Sigurisht sot zonat që mbajnë këto emërtesa si toponime nuk popullohen më nga i njëjti vegjetacion. Por ne mund të ndërtojmë qoftë edhe një përsiatje vizuale hipotetike të vegjetacioneve të trojeve tona në kohën kur u shfaqën këto toponime. Gjuhësia historike apo dialektologjia mund ta ofrojë këtë të dhënë, duke bërë madje një nënndarje të posaçme të fitonimeve në këtë skedar digjital që do të krijohet:

OB1: Planifikimi i Radhoit të Toponomastikës së Shqipërisë;

OB2: Digjitalizimi i fondit të skedave arkivore;

OB3: Gjurmimi etnografik i toponimeve dhe pajisja me gjurmën zanore të shqiptimit vendës;

OB4: Vjelja në terren e gjithë humusit historiko-popullor, gojëdhanor, mitologjik a proverbial, që lidhet me vetë toponimin a me komunitetin e banorëve të atyshëm.

OB5: Divulgimi te përfituesit direktë e indirektë

Nga digjitalizimi i skedave të fondit arkivor dhe bërja e përdorshme e tyre online përfitojnë:

Studiuesit e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me fokus fushat: antropologji, etnolinguistikë, sociolinguistikë, gjuhësi e sotme dhe historike, semantikë, histori, arkeologji etj.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD), si bashkëpjesëmarrës në projekt.



Profesorati dhe studentët e institucioneve të arsimit të lartë, të qendrave kërkimore, akademive, në Republikën e Shqipërisë, në Republikën e Kosovës, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Republikën e Malit të Zi, kudo ku zhvillohet mësimdhënie a kërkim shkencor në nivele tezash master, doktorature a projekte të përbashkëta me fokus shqipen e toponiminë e saj.

Profesorati, studentët, kërkuesit shkencorë në universitetet a qendrat kërkimore, akademive, kudo në botë, aty ku zhvillohet mësimdhënie a kërkim shkencor në nivele tezash master, doktorature a projekte të përbashkëta me fokus shqipen e toponiminë e saj.

Profesorati, studentët, kërkuesit shkencorë në universitetet a qendrat kërkimore, akademive, kudo në botë të interesuar për nisjen e projekteve të përbashkëta me fokus studime në rrafsh krahasimtar me shqipen.

Por ky projekt parashikon që prej tij të kenë përfitim edhe të tërthortë, dhe si të tillë renditen:

Bashkitë dhe komunat (pra pushteti lokal);

Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

Ministria e Ekonomisë, e Kulturës dhe e Inovacionit;

Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit;

Agjencitë turistike dhe kurset formuese të operatorëve turistikë;

Qendrat topografike për përimtimin e të dhënave;

OJF-të e përfshira në projekte a tematika mjedisore;

Institucionet homologe në krejt viset me popullatë shqiptare (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi), duke përfshirë edhe ngulime historike tonat në diaspora.

Mbledhje të komisioneve të përherhme pranë ASHSH

U zhvillua mbledhja e Komisionit të mjekësisë për analizën vjetore të punës për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025



Më 13 janar 2025 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua mbledhja e Komisionit të mjekësisë për analizën vjetore të punës për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025.

Ishin të pranishëm akad.emeritus Nestor Thereska, akad. Genc Sulçebe, prof. Albana Fico, prof. Anila Godo, prof. Xheladin Dracini, prof. asoc. Erda Qorri, prof. asoc. Arbi Pecani, prof. Suela Këlliçi, prof. Arjan Harxhi, prof. asoc Helidon Nina, prof. Ilir Alimehmeti (online).

Kryetari i Komisionit të mjekësisë akad. Genc Sulçebe paraqiti raportin e veprimtarive dhe analizën vjetore dhe vlerësoi punën e kryer nga ky komision, si dhe bashkëpunimin me njësitë dhe komisionet e ngritura pranë ASHSH-së.

Ai përmendi realizimin e dy konferencave të organizuara nga ky komision: konferencën ndërkombëtare “Kontrolli i shëndetit të ajrit dhe ujit: faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe premisa për zhvillim të qëndrueshëm”, të mbajtur në datat 4-5 korrik 2024 dhe konferencën e parë kombëtare me temë "Kanceri i gjirit, vëmendje jo vetëm në tetor - Të dhëna epidemiologjike, klinike dhe eksperiencia e Shqipërisë", të zhvilluar më 26 nëntor 2024.



Përgjatë këtij viti, Komisioni i mjekësisë në mbledhjet periodike ka trajtuar disa tema si :

- "Problematika e humbjes së dëgjimit në Shqipëri në moshat pediatrike dhe tek të rriturit", ligjëratë e mbajtur nga prof. Brikena Qirjazi, shefe e Shërbimit ORL te QSUNT.
- "Sëmundjet autoimune, epidemiologjia dhe roli i tyre në sëmundshmërinë e përgjithshme", ligjëratë e mbajtur nga prof. asoc Arbi Pecani, mjek reumatolog, spitali "Shefqet Ndroqi".
- "Gjendja e kardiologjisë në Kosovë dhe Shqipëri", ligjëratë e mbajtur nga dr. Gani Bajraktari.

Në përfundim të analizës së punës së realizuar gjatë vitit 2024, akad. Genc Sulçebe përmendi dhe faktin që në Komisionin e mjekësisë u pranuan tre anëtarë të rinj: prof. Suela Këlliçi, prof. asoc. Arbi Pecani dhe bashkëpunëtori i jashtëm prof. Gani Bajraktari.

Planet e veprimtarive për vitin 2025

Në lidhje me propozimet për aktivitetet që do të zhvillohen përgjatë vitin 2025, anëtarët e komisionit të mjekësisë diskutuan dhe bënë propozime si vijon:

Prof. Albana Fico sugjeroi që të ketë një vazhdimësi të konferencave për kancerin e gjirit, pasi në këtë drejtim kërkohen arritje të mëtjshme sipas standardeve bashkëkohore.



Prof. Anila Godo propozoi që për vitin 2025 vëmendja të përqendrohet në problemin e trajtimit të sëmundjeve tumorale. Ajo theksoi se ky trajtim duhet të fokusohet dhe në aspektin e cilësisë së jetës së të sëmurëve me kancer, si p.sh. te fëmijët, të cilët kërkojnë një trajtim të gjatë dhe të vëmendshëm për të mos lënë mbresa psikologjike më pas.

Prof. Dracini sugjeroi se një temë tjetër me rëndësi është dhe problematika e spektrit autik, i parë në aspektet e shëndetit të fëmijës dhe të cilësisë së jetës në familje. Pjesëmarrësit arritën në përfundimin se kjo temë duhet të trajtohet në një konferencë të veçantë dhe të shihet si një problem i shëndetit publik, jo vetëm klinik.

Prof. Harxhi theksoi se duhet trajtuar në mënyrë të veçantë tema e studimeve klinike të randomizuara me sfidat dhe infrastrukturën e nevojshme. Një problem tjetër që meriton vëmendje është antibiotikorezistenca. Akad. Thereska shprehu mendimin se kjo temë duhet të trajtohet nga Komisioni i mjekësisë gjatë këtij viti.

Në fund, u bë përzgjedhja e temave më të rëndësishme që do të trajtohen gjatë vitit 2025. Anëtarët e Komisionit shprehën gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për të shërbyer si komitete shkencore dhe organizative të veprimtarive të propozuara.

www.akad.gov.al

U zhvillua takimi për analizën mbi veprimtaritë e kryera nga Komisioni i përhershëm i gjuhësisë dhe i letërsisë për vitin 2024 dhe projeksionet e vitit 2025



Më 20 janar 2025 Komisioni i përhershëm i gjuhësisë dhe i letërsisë zhvilloi takimin për analizën mbi veprimtaritë e kryera dhe projeksionet e vitit 2025.

Veprimtaria u zhvillua me praninë e zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole; Drejtorit të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë akad. Valter Memisha; Kryetares së Komisionit të gjuhësisë dhe të letërsisë prof. dr. Anila Omari dhe anëtarëve të këtij komisioni.

Prof. Anila Omari tha se për vitin 2024, peshën kryesore në veprimtaritë e Komisionit të përhershëm të gjuhësisë e të letërsisë e kanë mbajtur punonjësit e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, të cilët, krahas veprimtarive të planifikuara dhe ato jashtë planit të vitit 2024, kanë kryer veprimtari edhe në bashkëpunim me Komisionin.

Gjatë këtij viti u realizuan dy aktivitete, që u përzgjedhën ndër propozimet e dhëna nga ish kryetari i Komisionit, akad. Valter Memisha në fillim të vitit: një konferencë dhe një tryezë shkencore, si më poshtë.

Në datën 18 tetor 2024 u zhvillua Konferenca shkencore me temën “Leksikografia shpjeguese shqipe e viteve ‘30-’40 të shek. XX”, organizuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Departamenti i Gjuhësisë e Qendra e Studimeve Albanologjike pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Midis këtyre dy institucioneve është vendosur prej disa vjetësh një bashkëpunim i frytshëm, që u pasqyrua edhe në organizimin e këtij

aktiviteti.

Më 29 tetor 2024, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, në bashkëpunim me komisionin e përhershëm të këtyre dy fushave, zhvilloi një tryezë shkencore me temën “Çështje të morfologjisë së sotme”, ku referuan Dr. Leonard Dauti nga IGJL dhe Dr. Resul Telhaj nga Universiteti i Elbasanit. Në diskutimet që pasuan rreth temave të trajtuara u përfshinë punonjës shkencorë të IGJL, anëtarë të Komisionit të Gjuhësisë e të Letërsisë e të ftuar nga institucionet e tjera akademike.



Prof. Omari e vuri theksin te njëra nga veprimtaritë më të rëndësishme të vitit të kaluar të organizuar nga Akademia e Shkencave: Tryeza shkencore ndërkombëtare “Shqipja midis gjuhëve indoeuropiane, origjina dhe lashtësia e saj”, e mbajtur më 4-5 nëntor 2024, e cila është vlerësuar si konferenca më e rëndësishme e viteve të fundit në fushën e albanologjisë. Në këtë konferencë u angazhuan në organizim dhe me pjesëmarrje aktive edhe anëtarë të Komisionit të përhershëm të gjuhësisë e të letërsisë si dhe punonjës shkencorë të IGJL.

Më tej, prof. Omari përmendi Kuvendin Mbarëkombëtar të Gjuhës Shqipe, organizuar më 21 dhe 22 nëntor 2024 nga Ministria e Arsimit me rastin e mbylljes së Vitit të Gjuhës Shqipe dhe Ditës së Alfabetit, për të cilin u angazhuan disa anëtarë të Komisionit, si prof. A. Omari, akad. Kristina Jorgaqi, prof. dr. Aljula Jubani, në drejtim dhe pjesëmarrje aktive në panelin për problemet aktuale të gjuhës shqipe. Një peshë të rëndësishme në Kuvend mbajti bashkëdrejtuesi i projektit të Fjalorit të madh të gjuhës shqipe, akad. Valter Memisha me prezantimin e FMGJSH-së dhe koordinatori e projektit prof. asoc. dr. Anila Kananaj.

Prof. Omari përmendi në raportin e saj edhe mbledhjet e zhvilluara nga Komisioni për diskutime lidhur me referimet që u mbajtën në tryezën shkencore “Çështje të morfologjisë së sotme”, për nevojën e diskutimit të strategjisë së kërkimit shkencor të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, si dhe për disa projekte për vitin 2025.

Pas raportit të analizës vjetore u bënë diskutime për çështje të ndryshme që meritojnë të zhvillohen në vitin në vazhdim, si disa probleme të drejtshkrimit të shqipes, strategjitë e kërkimit shkencor, çështje të letërsisë etj.

Në fund, u përcaktuan disa nga temat më të rëndësishme që duhet të trajtohen nga Komisioni i përhershëm i gjuhësisë dhe i letërsisë gjatë veprimtarive të vitit 2025.

www.akad.gov.al

U zhvillua analiza vjetore 2024 për veprimtarinë e Komisionit të arkeologjisë dhe projeksionet për vitin 2025

Takimi për analizën vjetore 2024 të Komisionit të arkeologjisë u zhvillua me praninë e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi, sekretares shkencore akad. Anila Hoda, kryetarit të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad. Gëzim Hoxha, Kryetarit të Institutit të Arkeologjisë akad. Adem Bunguri, prof. dr. Neritan Ceka dhe anëtarëve të Komisionit të arkeologjisë.



Kryetari i Komisionit të arkeologjisë prof. dr. Neritan Ceka paraqiti raportin e veprimtarisë gjatë vitit 2024. Ai vuri në dukje arritjet në tri drejtime kryesore: krijimin e një metodologjie të re në zhvillimin e kërkimeve arkeologjike, që vë në qendër karakterin albanologjik të saj dhe sqarimin e problemeve të rëndësishme të historisë së shqiptarëve; zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me universitetet shqiptare për aplikimin e metodave të shkencave ekzakte në kërkimet arkeologjike; zhvillimin e aktiviteteve shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare dhe botimin e materialeve të tyre.

Më tej, u diskutuan problemet që dolën gjatë kërkimeve arkeologjike për vitin 2024, të miratuara nga këshilli shkencor i Institutit të Arkeologjisë, dhe u vunë në dukje dy mangësi themelore, si mungesa e projekteve të mëdha dhe të përqendruara, që do të synonin në njërin anë hulumtimin e problematikave të kronologjisë, tipareve kulturore,

mënyrave të jetesës dhe organizimit social e politik etj., dhe në anën tjetër krijimin e siteve dhe hapësirave të vizitueshme me ndikim mbi turizmin kulturor dhe zhvillimin e qëndrueshëm vendor, por edhe përqendrimi i projekteve në pak persona, që drejtonin njëkohësisht disa prej tyre, gjithmonë me bashkëpunimin me partnerë të huaj. Në këto bashkëpunime kanë munguar specialistët dhe studentët shqiptarë dhe çfarë është kryesore, projektet zbatoheshin pa zbuluar monumente të rëndësishëm që do të zgjeronin hapësirat e vizitueshme në Apoloni, Butrint, Finiq etj.



Nga diskutimi në Komision u dha sugjerimi që të përqendroheshin forcat shkencore të departamentit të prehistorisë në trevat Korçë-Pogradec dhe të për zgjidhej një qendër e re e kërkimeve të prehistorisë në trevat jugore të vendit.

Për departamentin e antikitetit u sugjerua riformimi i ekipit të Apolonisë. Komisioni diskutoi edhe mbi nevojën e hapjes së një sektori të ri germimi në Apoloni, për të cilin është thirrur të paraqesë projektin përkatës dr. Marin Haxhimihali, si dhe për hartimin e një projekti të ri për Amantian, në të cilin do të angazhohen përveç Jamarbër Buzos, edhe prof. Skënder Muçaj dhe dr. Suela Xhyheri. Ky sugjerim u bë edhe mbi bazën e kërkesave të shtruara nga prof. Skënder Gjinushi për nevojën e tërheqjes në projektet e Institutit të Arkeologjisë edhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm, sepse duhet zgjeruar rrethi i studiuesve të specializuar.

Për departamentin e antikitetit u propozua nisja e një projekti më të gjerë për Amantian, duke e konsideruar si një nga qendrat kryesore të qytetërimit antik ilir, krahas Bylisit, Lisit, Dimalit dhe Antigonesë,

Një propozim i tretë u bë për Departamentin e antikitetit të vonë dhe mesjetës për krijimin e një ekipi që do të përqendrojë punën e tij në amfiteatrin e Durrësit.



Në kuadrin e ndihmesës për një shkallë të re të zhvillimit të kërkimeve arkeologjike, Komisioni mori edhe iniciativën për hartimin e një strategjie të kërkimeve arkeologjike për vitet 2025-2035, që lidhen me sqarimin e vazhdimësisë ilire-shqiptare. Si rrjedhim, nga grupi i punës dolën dy dokumente të veçantë: një strategji dhjetëvjeçare e kërkimeve arkeologjike për vitet 2025-2035 që vendos si prioritet problemet e karakterit albanologjik dhe një strategji e dytë për vitet 2025-2030 që parashtron detyrat e departamenteve aktuale të Institutit të Arkeologjisë.

Një drejtim i dytë i punës së Komisionit ka qenë promovimi i mëtejshëm i zbatimit të teknologjive bashkëkohore në dokumentimin e hulumtimeve arkeologjike, mbi bazën e bashkëpunimit me forcat shkencore të universiteteve. U krijua njësi Arkeomatika në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, përmes së cilës Fakulteti dhe Njësia aplikuan dhe fituan pranë AKSHI-t për pajisjen me dronin LIDAR të domosdoshëm në kartografimin e siteve arkeologjike.

Drejtimi i tretë i punës së Komisionit ka qenë mbledhja për përgatitjen për shtyp të akteve të Konferencës së nëntorit 2023 kushtuar 75 - vjetorit të inaugurimit të Muzeut Arkeologjik si bërthama e parë e Institutit të Arkeologjisë dhe 100- vjetorit të lindjes së prof. Selim Islami. I gjithë material i vëllimit është mbledhur dhe i është kaluar nga drejtori i Institutit dy punonjësve të tij për ta përgatitur për botim si një numër i veçantë i revistës "Iliria" të vitit 2024.

U zhvilluan takimet e 8 redaksive vendore Shqipëri - Kosovë për Enciklopedinë shqiptare



Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizoi në datat 22, 23 dhe 24 janar 2025 takimet e 8 redaksive vendore Shqipëri – Kosovë për “Enciklopedinë shqiptare”. Këto takime u zhvilluan në sallën “Akademikët” të Akademisë së Shkencave, Tiranë.

Gjatë tri ditëve të zhvillimit të këtyre takimeve ishin të pranishëm: zëvendëskryedaktori i “Enciklopedisë shqiptare” akad. Mehmet Kraja, njëkohësisht edhe drejtues i redaksisë vendore Kosovë; zëvendëskryetari i ASHSH-së akad. Vasil Tole dhe koordinаторët e redaksive të ESH-së të të dyja vendeve: znj. Lendita Pula, sekretare e redaksisë vendore Kosovë; znj. Dafina Kavaja, koordinatore Kosovë; znj. Drisela Diamanti, koordinatore e QBAE-së; znj. Enkelejda Misha, koordinatore e QBAE-së.

Në ditën e parë të punimeve ishin pjesëmarrës redaktorët përgjegjës të fushave gjuhësi (albanologji) religjioni, arsimit: Anila Omari, Bardh Rugova, Albert Nikolla, dr. Jahja Dracolli, Geron Kamberi, Naser Zabeli.

Në ditën e dytë të punimeve ishin pjesëmarrës redaktorët përgjegjës të fushave gjeografi fizike, gjeografi sociale, sportet: Skënder Sala, Valbon Bytyqi, Dhimitër Doka, Arsim Ejupi, Lluka Heqimi, Albert Mecini.

Dita e tretë dhe e fundit e punimeve, 24 janar 2025, u zhvillua me pjesëmarrjen e

redaktorëve përgjegjës të fushave: shkencat e natyrës fizikë –matematikë-informatikë, kimi-biologji, si dhe sistemet politike e drejtësia: Fatmir Hoxha, Besnik Baraj, Fetah Podvorica, Aurela Anastasi, Arsim Bajrami.



Në këto takime u morën vendime që disa nga njësitë themelore të shkruhen në rend të drejtë dhe të unifikohen, për riadresimin e njësive, të shmangen mbivendosjet dhe u diskutuan konceptet e qasjet për toponimet dhe zhvillime të caktuara historike në kohë të ndryshme.

Komisioni i matematikë-informatikës zhvilloi analizën vjetore të punës kërkimore shkencore të vitit 2024

Analiza vjetore e punës kërkimore shkencore të vitit 2024 e Komisionit të informatikë-matematikës u bë në lidhje me punën e kryer në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Matematikës dhe Njësinë e inteligjencës artificiale.

Në këtë takim morën pjesë sekretarja shkencore e Akademisë së Shkencave akad. Anila Hoda; Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad. Neki Frashëri; akad. asoc. Kozeta Sevrani, kryetari i Komisionit të informatikë-matematikës, prof. dr. Fatmir Hoxha; prof. dr. Betim Çiço, dr. Romina Muka, prof. dr. Eglantina Kalluçi; online: dr. Adrian Naço, prof. asoc. Robert Kosova, prof. Eriola Sila.



Kryetari i komisionit, prof. dr. Fatmir Hoxha hapi mbledhjen dhe u ndal në punën e kryer nga Komisioni në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Matematikës dhe IM gjatë vitit 2024.

Akad. Hoxha përmendi organizmin e 8 veprimtarive, seminareve e konferencave shkencore kombëtare e mbarëkombëtare, dhe e vuri theksin në organizimin dhe zhvillimin e konferencës shkencore “Akademik Petraq Pilika, themeluesi i shkollës shqiptare të matematikës “in memoriam: me rastin e 100- vjetorit

të lindjes së akademik Petraq Pilika, që organizua më 3 qershor 2024, në bashkëpunim me Departamentin e Matematikës, FSHN, UT.

Gjithashtu ai vlerësoi edhe punën e bërë nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, me nismën e bordit të IKM-së dhe KMI-së për themelimin e çmimit “Pilika” me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akademikut që ndahet në tri kategori: doktorata më e mirë, punimi më i mirë shkencor, karriera në matematikë.



Pas analizës vjetore u bënë propozime dhe diskutime për vitin 2025:

U theksua se do të konsolidohet seminari i matematikës, me më shumë lektorë shqiptarë jashtë Shqipërisë dhe nga universitetet tona, për ta shndërruar atë në një seminar të përmuajshëm (duke vendosur një ditë të javës dhe një orë fikse) dhe do bëhen përpjekje më të mëdha për të siguruar dëgjues të interesuar. Ky seminar i shërben stafit akademik brenda vendit dhe doktorantëve të Matematikës në UT dhe UPT-së.

Do të bëhet digjitalizimi i kërkimit shkencor në matematikë (Evidentimi i veprimtarisë shkencore në departamentet e të gjitha universiteteve, afrimi i kërkuesve sipas fushave dhe nënfushave të matematikës nëpërmjet punimeve, duke i shndërruar në grupe specialistësh të kualifikuar)

Gjithashtu pritet të zhvillohet edhe një analizë e kërkimit shkencor në matematikë, në vendin tonë, duke u nisur nga dy qasje: Kërkimi shkencor aktual dhe kërkimi shkencor duke u nisur nga doktoraturat e mbrojtura që në fillimet e kërkimit

matematik.

Do bëhen përpjekje më të mëdha për hartimin dhe fitimin e projekteve në bashkëpunim me Departamente të Universiteteve shqiptare ose të huaja, si p.sh., ato të mbështetura nga AKKSHI, ERASMUS+, HORIZON etj.



Një vend të veçantë në projektet e këtij komisoni do të zërë konferenca e 3-të kombëtare e Matematikës, që mund të quhet edhe Annual Albanian Conference of Mathematics-2025. Kjo konferencë do përfshijë të gjitha fushat e matematikës që lëvrohen tek ne dhe për pasojë do jetë më e madhe në numër punimesh dhe autorësh. Konferenca parashikohet në tetor.

Gjithashtu do të zhvillohen simpoziume e ëorkshope të propozuara kryetari i komisionit, ndërsa ta komitetet shkencore dhe organizative do merren me masat për organizimin sa më efektiv të këtyre veprimtarive të propozuara.

Komisioni i përhershëm i ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike zhvilloi takimin për analizën e veprimtarive të 2024 dhe projeksionet e vitit 2025

Në datën 22 janar 2025 u zhvillua mbledhja e Komisionit të përhershëm të Ekonomisë, Shkencave Sociale dhe Juridike me pjesëmarrjen e akad. Anastas Angjelit, kryetar i Komisionit; akad. Adrian Civicit, anëtar; akad. Aurela Anastasit, anëtare; prof. Andrea Koxhaj, anëtar; prof. Ksenofon Krisafi, anëtar; prof. Besmir Premalaj, anëtar; z. Altin Tanku, anëtar; prof. Ilirjana Nano, anëtare; prof. Arta Mandro, anëtare; prof. Nikollaq Pano, anëtar. Ndërkohe morën pjesë online akad. Kosta Barjaba, anëtar; prof. Selami Xhepa, anëtar; prof. Klodiana Gorica, anëtare.



Takimi u bë në praninë e kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi, për analizën vjetore të Komisionit për vitin 2024 dhe më tej, për të bërë propozime e diskutime për veprimtaritë e Komisionit për vitin 2025, përfshirë konferenca, simpoziume, tryeza shkencore.

Kryetari i Komisionit, akad. Angjeli, paraqiti raportin e veprimtarive dhe projekteve të realizuara gjatë vitit 2024. Ai vuri në dukje se janë zhvilluar 6 mbledhje nga ky komision.

Mbledhjen e parë ky komision e ka zhvilluar më datë 09.04.2024 me vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe botuese të akad. asoc. Adrian Civicit. Më 01. 07

.2024 u zhvillua mbledhja e dytë me referimin e akad. Adrian Civici me temë "Mendimi ekonomik shqiptar në gjysmën e parë të shek. XX". Akad. Civici përmendi zhvillimet e hershme dhe stabilitetin e pjesshëm ekonomik gjatë viteve 1925-1928, duke përfshirë: Iniciativat për organizimin e shoqërive aksionere në industri, ndërtim dhe transport; Krijimin e monedhës së parë shqiptare, franga ar shqiptare; Futjen e kapitalit të huaj si politikë zyrtare e qeverive të Zogut.

Në datën 02.09.2024, akad. Anastas Angjeli mbajti një ligjëratë, ku theksoi rëndësinë e debatit të gjatë 30-vjeçar për zhvillimin ekonomik dhe social, duke u fokusuar në krijimin e indekseve të reja për vlerësimin e lumturisë dhe kënaqësisë së popullsisë. Ai iu referua marrëveshjes së Bretton Woods-it, krijimit të institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare si FMN dhe Banka Botërore, si dhe zhvillimit të sistemit ndërkombëtar monetar.

Në datën 22.10.2024, Komisioni zhvilloi mbledhjen e radhës, ku edhe prof. Klodiana Gorica mbajti një ligjëratë mbi integrimin e edukimit në turizëm. Ajo shqyrtoi sfidat e turizmit shqiptar dhe rëndësinë e edukimit në këtë fushë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe për të siguruar një forcë punëtore të kualifikuar.

Më datë 28.10.2024 Komisioni zhvilloi një mbledhje të zgjeruar me të ftuar, nën kujdesin e akad. Aurela Anastasi. z. Gerald Jaupaj foli mbi procesin e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian për Kapitullin 25, i cili përfshin shkencën dhe kërkimin shkencor.

Në mbledhjen e datës 16.12.2024, gjatë ligjëratës së tij, prof. Andrea Koxhaj dha një përkufizim të detajuar të telepunës, duke e dalluar nga puna e thjeshtë në distancë.

Akad. Angjeli u ndal më pas te konferencat e realizuara duke shtuar se Komisioni, me miratimin e Kryesisë, u bë pjesë e organizimit me Ministrinë e Turizmit (Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit) të Konferencës Ndërkombëtare "Turizmi në Evropën Qendrore dhe Juglindore-Rrugë të reja Zhvillimi".

Gjithashtu, Kryetari i Komisionit u ndal dhe te botimet, ku anëtarët e komisionit janë përfshirë në botime shkencore dhe publicistike, të cilat raportohen dhe nga anëtarët e tjerë jo anëtare të ASH, në institucionet e tyre.

Nën drejtimin e akademik Anastas Angjelit dhe Justina Shiroka-Pula në vitin 2024, u botua libri i përmbledhjes së punimeve të konferencës së përbashkët të ASHSH-së dhe ASHAK-ut "Sfidat dhe perspektiva e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon". Akademik Anastas Angjeli gjatë vitit 2024 publikoi librin "Institucionet e Brettton Woods-it dhe Shqipëria".

Katër anëtarë të komisionit bëjnë pjesë në *Redaksinë e ekonomisë, financës dhe tregtisë* dhe sipas programit kanë përgatitur zërat dhe vazhdon puna në përputhje me programin. Gjithashtu puna ka vazhduar për Projektin "Vlerësimi i gjendjes dhe sfidave të shkencave ekonomike në Shqipëri".

Akad. Aurela Anastasi falënderoi kryetarin e Komisionit për prezantimin e raportit dhe mbështeti propozimin për të zgjeruar komisionin. Ajo u shpreh për disa pika të organizimit sa më të mirë të punës dhe veprimtarive të këtij komisioni. Akad. Anastasi propozoi që në muajin shkurt ose mars të zhvillohet një veprimtari “E drejta për shkencën”, në bashkëpunim me Këshillin Ndërkombëtar të Shkencës. Me synimin që të ketë një ballafaqim midis ligjit për shkencën dhe kuptimit të së drejtës për shkencën.

Pas raportit të analizës vjetore, u propozuan dhe diskutuan *aktivitetet e Komisionit për vitin 2025*.

Në përfundim të këtij takimi, Kryetari i ASHSH-së akad. Skënder Gjinushi vlerësoi punën e Komisionit; si një komision mjaft aktiv jo vetëm si numër, por edhe në cilësi. Ai u shpreh me tej se ka një bashkëpunim shumë të mirë me Bankën e Shqipërisë dhe me Ministrinë e Financave dhe se qeveria duhet t’i dëgjojë më shumë strukturat shkencore. Akad. Gjinushi i vlerësoi tematikat e propozuara për vitin 2025 për larminë dhe seriozitetin dhe premtoi mbështetjen e Kryesisë së ASHSH-së për nxitjen dhe realizmin e projekteve e veprimtarive të këtij komisioni.

Takime pune

U zhvillua një takim me përfaqësues të Ministrisë së Bashkëpunimit Rajonal të Izraelit dhe përfaqësues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Më 24 janar 2025 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u pritën në takim zyrtarë të lartë të Ministrisë së Bashkëpunimit Rajonal të Izraelit dhe përfaqësues të Ambasadës së Izraelit në vendin tonë.



Sekretarja shkencore, akad. Anila Hoda, së bashku me prof. dr. Ariola Bacu, anëtare e Qendrës për Bioteknologji dhe Gjenetikë dhe Qendrës NanoAlb, pjesë e ASHSH-së, dhe prof. asoc. dr. Elda Zotaj, drejtuese e sektorit të marrëdhënieve me jashtë dhe publikun, pritën delegacionin nga Ministria e Bashkëpunimit Rajonal të Izraelit, që përbëhej nga z. Gilad Shadmon, drejtor i përgjithshëm; znj. Sonya Ishenko, drejtoreshë kabineti e drejtorit të përgjithshëm; znj. Shlomit Orbach, drejtoreshë e nismave rajonale, partneriteteve qeveritare dhe marrëdhënieve me jashtë dhe z. Klajd Heta, përfaqësues i ambasadës së Izraelit në Shqipëri.

Takimi pati në fokus zgjerimin e bashkëpunimit të ndërsjellë me synim zhvillimin e kërkimit shkencor në fusha prioritare si inovacioni e kultura, organizime të projekteve e veprimtarive të tjera të përbashkëta etj, në përputhje me prioritetet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Drejtori i përgjithshëm në Ministrinë e Bashkëpunimit Rajonal, z. Gilad Shadmon, shprehu kënaqësinë për gatishmërinë e treguar nga Akademia e Shkencave

për organizimin e këtij takimi. Ai u shpreh se institucioni që ai përfaqëson bën të mundur lidhjen e universiteteve të Izraelit me rrjetin e institucioneve rajonale ndërkombëtare dhe mbështet financiarisht bashkëpunime ndërmjet palëve. Përfaqësuesit e delegacionit të Ministrisë së Bashkëpunimit Rajonal të Izraelit prezantuan me këtë rast kategoritë e përvitshme të thirrjeve të hapura për financim veprimtarish të lidhura me arsimin, shoqërinë, botën akademike, kërkimin shkencor, kulturën dhe sportin. Ata vunë në dukje se thirrjet përfshijnë veprimtari, si: projektet, konferencat, shkëmbimet e studentëve dhe stafit akademik, partneritetet institucionale, etj.



Sekretarja shkencore e Akademisë së Shkencave, akad. Anila Hoda, i njohu të pranishmit me vizionin, strukturën dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave dhe zhvillimet më të fundit në fushën e kërkimit shkencor dhe projekteve. Ajo e vuri theksin te disa veprimtari mbështetëse që ka bërë Akademia e Shkencave e Shqipërisë në dobi të ruajtjes dhe pasurimit të kujtesës historike për fatin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe çështjen e ndriçimit të historisë së bashkëjetesës dymijëvjeçare të shqiptarëve e hebrenjve, si bashkëhartuese e ligjit për shpalljen e “Ditës së Kujtesës” (2003) dhe organizatore e disa konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare kushtuar Holokaustit.

Prof. Ariola Bacu, foli për linjat kryesore të bashkëpunimit aktual në fushën e

bioteknologjisë me institucionet e kërkimit shkencor në Izrael. Ajo vuri në dukje arritjen e nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi midis Universitetit “Ben-Gurion”, Negev, Izrael dhe ASHSH-së në muajin tetor të vitit 2024, falë bashkëpunimit disavjeçar mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nën drejtimin e prof. Ariola Bacu (Departamenti i Bioteknologjisë, Universiteti i Tiranës) dhe Universitetit “Ben-Gurion”, Negev, nën drejtimin e prof. Robert Marks (Departamenti i Inxhinierisë Bioteknologjike).

Prof. Bacu përmendi se gjatë këtij viti bashkëpunimi do të vijojë me organizimin në Tiranë të Kongresit European të Bioteknologjisë - EBTNA-2025, në të cilin do të marrin pjesë profesorë e kërkues shkencorë nga institucionet e Izraelit, si edhe me realizimin e dy projekteve ndërkombëtare të koordinuara nga ASHSH-ja, si edhe të një projekti të drejtuar nga BGU-ja (Prof. Ariel Kushmaro) dhe të financuar nga Ministria e Bashkëpunimit Rajonal të Izraelit.

Në fund të këtij takimi, përfaqësuesit e Ministrisë së Bashkëpunimit Rajonal të Izraelit dhe të Ambasadës së Izraelit shprehën vullnetin e palës së tyre për të mundësuar bashkëpunime në fusha me interes të përbashkët dhe bënë propozime për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis institucioneve e kërkuesve shkencorë të të dyja vendeve.

Të tjera

Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes shkrimtarin dhe akademikun e saj Fatos Kongoli

Jetë të gjatë, shëndet e vepra të tjera po kaq të arrira!



Matematikën dhe shkrimtar, akademiku Fatos Kongoli ka sot ditën e tij të lindjes. Akademia e Shkencave uron në ditën e tij të lindjes jetë të gjatë, shëndet e vepra të tjera po kaq të arrira!

Fatos Kongoli lindi në Elbasan më 1944. Studimet e larta për matematikë i nisi në Universitetin e Pekinit dhe i përfundoi në Universitetin e Tiranës (1967). Ka punuar për një kohë si gazetar dhe më pas si redaktor në Shtëpinë botuese "Naim Frashëri". Filloi të botonte tregime e novela në shtypin letrar nga fundi i viteve '60. Deri në vitet 1990 ka botuar vëllimet me tregime "Shqetësime të ngjashme" (1972), "Tregime" (1978), "Të fejuarit" (1982), si dhe romanet "Ne të tre" (1985), "Karuseli" (1990). Në tregimet dhe novelat e tij të para F.K. për zgjedh "jetët e vogla" njerëzore, duke paraqitur bashkë virtute dhe cene të individualiteteve të botës shqiptare. Prej v. 1990 priret nga romani: "I

humburi" (1992), "Kufoma" (1994), "Dragoi i fildishtë"(1999), "Ëndrra e Damokleut" (2001), "Lëkura e qenit" (2003, fitues i çmimit "Pena e artë"), "Te porta e Shën Pjetrit" (2005), "Jetë në një kuti shkrepësesh" (2007),"Bolero në vilën e pleqve"(2009). "Iluzione në sirtar"(2010), "Si-do-re-la" (2011),"Njeriu me fat" (2013), "Gjemia e mbytur" (2015) etj. Me romanet ai thelloi tiparet e individualitetit të vet krijues. Merita e veçantë e tyre është trajtimi i temave të kohës së sotme, paraqitja e njeriut të shoqërisë së hapur me rreziqet që i kanosen, si rreziku riideoogjizues, shpërbërja, shthurja e idealeve, kurdisja e mekanizmave të tjerë të orientimit të njeriut në jetë. Vepra të tij janë botuar në njëmbëdhjetë gjuhë të huaja, me jehonë në disa nga gazetatat dhe revistat më të mëdha europiane. Ka fituar tri herë çmimin "Pena e argjendtë" për librin më të mirë në prozë (1995, 2000, 2002), si dhe çmime të tjera brenda dhe jashtë vendit. Është nderuar me titullin "Kalorës i Legjonit të Nderit" (2010) nga Presidenti i Francës, dhe "Mjeshtër i madh"(2012) nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë. Në vitin 2017 është nderuar me titullin Doktor "Honoris Causa" nga Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë.

www.akad.gov.al

In memoriam

Kryesia e Akademisë së Shkencave kujton me nderim akademikun dhe shkrimtarin emblematic të letërsisë shqipe Ismail Kadare

- Me rastin e 89-vjetorit të lindjes (28 janar 1936 - 1 korrik 2024)-



Shkrimtari i shquar Ismail Kadare (28 janar 1936 - 1 korrik 2024), anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka sot 89-vjetorin e lindjes.

Në këtë ditë të shënuar Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e kujton me nderim dhe përulet me respekt para trashëgimisë së jashtëzakonshme letrare dhe shkencore të shkrimtarit të madh Ismail Kadare.

Ismail Kadare lindi në Gjirokastrë më 28 janar 1936. Qyteti i lindjes e ndoqi përjetësisht kudo që ai jetoj e shkroi, në Perëndim e në Lindje, duke u bërë pjesë e pandashme e krijimtarisë së tij në të gjitha fazat e jetës. Me një opus letrar që përmban mbi 70 vepra, në të gjitha llojet e nënlojet e letërsisë, eseistikës dhe publicistikës, të panumërta në botime e ribotime, Ismail Kadare ka zënë e do të ketë kryet e vendit në

historinë e letërsisë shqipe.

Kryesia e ASHSH-së e vlerëson Ismail Kadarenë si kryemjeshtrin e letërsisë shqipe, një figurë identiteti për popullin shqiptar, krahas figurave të tilla, si Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, Ismail Qemali e Nënë Tereza. Vepra e tij është pasuri e jashtëzakonshme e letërsisë shqipe dhe e shkencës së albanologjisë. Gjithashtu, vepra e Kadaresë është një gur i çmuar në letërsinë europiane dhe atë botërore.

Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Kadareja ka qenë dhe do të mbetet emblema e saj, krahas vendit që ai ka zënë me plot meritë në shumë akademi dhe universitete brenda e jashtë vendit, ku është nderuar me titullin akademik “doctor honoris causa”.

Akademiku dhe shkrimtari i shquar shqiptar Ismail Kadare është fitues i çmimeve letrare më të rëndësishme në Europë e në Botë (“International Booker Man Prize”, “Prince of Asturias Award”, “Jerusalem Prize”, “Neustadt International Prize”, “Nonino”, “Park Kyong-ni”).

Ismail Kadare është shkrimtari më i rëndësishëm i letërsisë shqipe që prej fillimeve dhe gjatë pesë shekujve të jetës së saj. Vepra e tij i ka kaluar me kohë kufijtë e Shqipërisë, të letërsisë dhe gjuhës shqipe, të botës shqiptare, dhe është bërë pjesë cilësore në trashëgiminë e letërsisë botërore.

Për dekada me radhë vepra e Kadaresë ishte burim informacioni për Botën lidhur me realitetin shqiptar krejt të mbyllur. Sot kjo vepër shërben si një pasaportë identiteti dhe si një histori alternative e popullit shqiptar gjatë shekujve dhe sidomos në kohët e reja. Njohës dhe interpretues i miteve dhe i kodeve tradicionale, njohës i vlerave europiane po aq sa dhe i kufizimeve në të kuptuarit e njeriut shqiptar, ai dekodifikoi dhe i shërbeu “lexuesit tjetër” nyjat më të ndërlikuara të së shkuarës dhe së sotmes së popullit të vet. Shkroi në kushtet e kufizimeve të rrepta ideologjike, u bë dritare për të parë dhe program për të lexuar Perëndimin dhe për t’u njohur prej tij; u dha liri njerëzve kur nuk kishte liri; i provoi të gjitha fazat e raporteve kritike me pushtetet, prej entuziazmit e besimit futurist te dyshimi, prej dyshimit te kontestimi, prej kontestimit në refuzim e prej refuzimit në disidencë letrare, duke shkruar letërsi normale në kushte historike jonormale.

Letërsia e I. Kadaresë e ka ndërkombëtarizuar kulturën shqiptare në shkallë europiane e botërore. Gjuhët me të cilat ka folur letërsia e tij janë mbi 50 dhe numri i titujve të botuar e ribotuar jashtë gjuhës amtare është mbi 1500.

Vepra e tij studiohet në universitete në kuadër të historisë së letërsisë europiane dhe të asaj botërore. Shkencës së albanologjisë tashmë i është shtuar një degë e re, ajo e kadareologëve, e studiuesve dhe përkthyesve të veprës së tij. Nën ndikimin e kësaj dege të re, edhe vendi i gjuhës shqipe në universitete është rritur me hapjen e katedrave dhe njësive të reja, që nga Japonia në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që nga Franca në

Rusi. Sot vepra e Kadaresë përkthehet e studiohet edhe në ndonjë vend ku ka pasur kufizime.

Ismail Kadare është dhe do të mbetet një autoritet moral për popullin shqiptar, një institucion krijimi dhe mendimi, një referencë themelore për jetën e tij. Vepra që ai ka krijuar është e lidhur me çështje thelbësore të botëkuptimit shqiptar e ballkanas, të ndërveprimit të kulturave dhe vlerave qytetare të rajonit, të evoluimit të identiteteve historike e kulturore. Ajo është një dritare e rëndësishë parësore për të njohur edhe psikozat dhe komplekset e popujve të Europës Juglindore, aspiratat e vërteta të tyre.

Letërsia e Kadaresë lexohet e vlerësohet në vazhdimësi, pasi mesazhet e veprës që ka krijuar, fuqia e fjalës dhe e mendimit të tij e bëjnë këtë vepër gjithnjë të kohës dhe tërheqëse për lexuesit e saj.

Emri dhe vepra e Ismail Kadaresë do të jenë përjetësisht të pranishme në jetën e shqiptarëve dhe të gjithë Botës.

www.akad.gov.al

Ndërroi jetë në moshën 79-vjeçare akademik emeritus Jani Vangjeli, botanist dhe specialist i florës së Shqipërisë



Sot, më datë 10 janar 2025, ndërroi jetë në moshën 79-vjeçare akademik emeritus Jani Vangjeli, botanist dhe specialist i florës së Shqipërisë, lindur në Tiranë, më 23 qershor 1945.

Jani Vangjeli kreu shkollën e mesme dhe studimet e larta në Fakultetin e Shkencave Natyrore, të Universitetit të Tiranës, ku dhe u diplomua në biologji në vitin 1967. Në vitet 1969-1982 punoi si pedagog në katedrën e botanikës të Universitetit të Tiranës e prej vitit 1980 e deri në vitin 2007 ka punuar si kërkues shkencor në Institutin e Kërkimeve Biologjike, duke qenë edhe përgjegjës i Sektorit të florës, gjatë viteve 1990-1993, dhe drejtor e kryetar i Këshillit Shkencor të këtij Instituti në vitet 1993-1998. Në rolin e drejtuesit të Institutit hapi drejtime të reja shkencore në fushën e studimeve ekologjike të formacioneve bimore, të dinamikës së vegjetacionit etj. Për veprimtarinë e tij të gjerë shkencore e të dalluar ai fitoi titullin profesor në vitin 1994 dhe u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në vitin 2008.

Me punimet e tij, akademik Jani Vangjeli ka dhënë kontribut për studimin e florës dhe të vegjetacionit, duke u përqendruar sidomos në studimin e bimëve të rralla dhe të kërcënuara, të biodiversitetit e të vegjetacionit potencial natyror. Ai është

bashkautor i 3 vëllimeve të veprës "Flora e Shqipërisë", autor i disa monografive dhe ka qenë drejtues dhe redaktor shkencor i veprës "Excursion Flora of Albania", botuar në Gjermani në vitin 2015. Si autor i veprës së tij madhore "Atlas i Florës së Shqipërisë", vëllimi i parë i të cilit u botua në 2016, vepër që përbën një domosdoshmëri në studimet e thelluara për florën e Shqipërisë dhe që do të kontribuojë në studimet e tjera në fushën e pyjeve, kullotave, bimëve aromatike e mjekësore, farmaceutikës, leksikografisë, u nderua me çmimin më të lartë të Akademisë së Shkencave në fushën e shkencave natyrore-teknike "Petrît Radovicka".

Pjesë e veprimtarisë së tij të shumanëshme janë edhe botimet Pyjet e virgjëra të Shqipërisë, Libri i Kuq (Bimë, shoqërime bimore dhe kafshë të rrezikuara), Botanika, Gjeobotanika, Fjalor i emrave të bimëve, Fjalori i terminologjisë së botanikës, Fjalori shpjegues i termave të botanikës, si dhe kontributi si bashkautor i Map of the Natural Vegetation of Europe – Harta e bimësisë natyrore të Europës, i botuar në Gjermani, në vitin 2000.

Jani Vangjeli ka qenë koordinator në shumë projekte shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si: "Ecological Survey of High Forests of Albania", World Bank, "Set up a contemporary database on Albanian Flora", Harta e Vegjetacionit Natyror të Europës, në bashkëpunim me Universitetin e Lancasterit, projekti i EEA, projekti i "CORINE Biotopes in Albania" etj.

Anëtar i bordit shkencor në disa revista shkencore, si: "Botanika Chronica" që botohet në Patra; "Studime Biologjike", revistë kjo e Institutit të Kërkimeve Biologjike dhe "Journal of Natural and Technical Sciences", botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Me ndarjen nga jeta të akademik emeritus Jani Vangjelit, Akademia e Shkencave humbet një nga anëtarët e vyer të saj në shkencat natyrore-teknike, kërkues shkencor i përkushtuar dhe koleg i shkëlqyer.

Ceremonitë e nderimit, datë 11 janar 2025, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë:

Ora: 10.00 - 10.45 - Akademi Solemne në nderim të figurës së akademikut Jani Vangjeli.

Ora 11.00 - 12.30 - Homazhet, në Sallën "A. Buda".

Ora 12.30 - Fjala e përmotshme e përcjelljes, nga Kryesia e ASh-së.

<https://ata.gov.al/.../ndahet-nga-jeta-akademiku-jani.../>

<https://shqiptarja.com/.../nderron-jete-ne-moshen...>

www.akad.gov.al

Fjala e lamtumirës e Kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi për akademik emeritus Jani Vangjelin

Akad. Skënder Gjinushi: Me ndarjen nga jeta të akademik emeritus Jani Vangjelit, Akademia e Shkencave humbet një nga anëtarët e vyer të saj në shkencat natyrore-teknike, një kërkues shkencor të përkushtuar dhe një koleg të shkëlqyer-

-Akad. Gjinushi: Jani Vangjeli u bë një nga vazhduesit e trashëgimtarët e drejtpërdrejtë të veprimtarisë kërkimore shkencore në fushën e shkencave botanike, të plejadës së profesorëve e studiuesve të shquar Kolë Paparisto, Sali Mborja, Xhaferr Qosja, Ilia Mitrushi, të cilët hodhën themelet e kësaj fushe. Si njohës i shkëlqyer i natyrës ka dhënë ndihmesën e tij të veçantë në njohjen dhe ruajtjen e biodiversitetit-



Të dashur pjesëtarë të familjes së Jani Vangjelit

Të nderuar miq, të afërm e kolegë të Janit

Sot jemi mbledhur këtu për t'i dhënë lamtumirën e fundit mikut e kolegut tonë, shkencëtarit e profesorit, akademikut Jani Vangjeli.

Kjo është një ditë e trishtë për të gjithë ne, për familjen e tij, për bashkëshorten, dy vajzat, motrat e nipërit, për tërë komunitetin akademik e universitar në Shqipëri e Kosovë e veçanërisht për ata që i janë kushtuar shkencës së florës e të faunës, të cilët

humbën një zë autoritar, drejtues e bashkëpunëtor të vyer në studimet e tyre.

Akad. Jani Vangjeli i përket asaj plejade shkencëtarësh që u përgatitën në bankat e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në të cilin ai u diplomua për biologji, në vitin 1967, pas kryerjes me rezultate të larta të shkollës së mesme.



Karrierën e tij mësimore shkencore prof. Jani e filloi si pedagog pranë katedrës së Biologjisë në Institutin Pedagogjik të Shkodrës e shumë shpejt, falë aftësive të tij, ai u bë pjesë e Katedrës së Botanikës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës ku punoi si pedagog në katedrën e botanikës deri në vitin 1982, e prej vitit 1980 deri në vitin 2007 ai u angazhua si kërkues shkencor në Institutin e Kërkimeve Biologjike, duke qenë edhe përgjegjës i Sektorit të florës, gjatë viteve 1990-1993, dhe drejtor e kryetar i Këshillit Shkencor të këtij Instituti në vitet 1993-1998. Në rolin e drejtuesit të Institutit ai hapi drejtime të reja shkencore në fushën e studimeve ekologjike të formacioneve bimore e të dinamikës së vegjetacionit.

Jani Vangjeli gjatë gjithë jetës së tij është dalluar për këmbënguljen, seriozitetin dhe vullnetin e fortë. Me këto karakteristika ai arriti shumë shpejt të bëhej një nga njohësit dhe studiuesit më të mirë në fushën e Sistematikës së Bimëve. Jani ishte njeriu i punës në terren ashtu siç e kërkojnë edhe shkencat Botanike. Si i tillë, ai u bë një nga kontribuuesit më në zë të studimit të Florës shqiptare duke u shndërruar në një nga bashkëautorët më të dalluar në përgatitjen e veprës madhore Flora e Shqipërisë. Formimi e kompetenca shkencore e Janit u pasurua në vazhdimësi edhe përmes specializimeve jashtë vendit si në Itali, Angli, Belgjikë, Gjermani në fusha të reja si informatizimi i florës, ndotja e mjedisit a ekologjia bimore.

Kështu ai u bë një nga vazhduesit e trashëgimtarët e drejtpërdrejtë të veprimtarisë kërkimore shkencore në fushën e Shkencave Botanike, të plejadës së profesorëve e studiuesve të shquar Kolë Paparisto, Sali Mborja, Xhaferr Qosja, Ilia Mitrushi, të cilët hodhën themelet e kësaj fushe.

Për veprimtarinë e tij të gjerë e të spikatur shkencore Jani fitoi titullin profesor në vitin 1994 dhe u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në vitin 2008, duke u bërë për 17 vjet një prej anëtarëve më aktivë e më me kontribut të saj.



Përmes punës së tij të gjatë dhe këmbëngulëse, duke shkelur terrenin e zonave të ndryshme të vendit, Jani u bë një nga ndërtuesit e pasuruesit më të përkushtuar të Herbarit Kombëtar duke punuar njëkohësisht edhe në drejtimet e reja të fushës së Ekologjisë së Bimëve dhe formacioneve të ndryshme bimore. Në këtë kuadër ai ka marrë pjesë në një sërë projektsh kombëtare e ndërkombëtare si: “Vëzhgim ekologjik i pyjeve të lartë të Shqipërisë”, projekt i Bankës Botërore, “Krijimi i bazës së të dhënave bashkëkohore mbi Florën e Shqipërisë”, “Harta e Vegjetacionit Natyror të Europës, projekt në bashkëpunim me Universitetin e Lancasterit, apo projekti “European për Biotopet Corine në Shqipëri”.

Si specialist i njohur edhe ndërkombëtarisht në fushën e tij, si njohës i disa gjuhëve të huaja Jani Vangjeli ka qenë anëtar i redaksive të disa revistave shkencore brenda e jashtë vendit si: revista Botanica Chronica, (Patras,Greqi), revista shkencore e ASH Journal of Natural and Technical Sciences, e si kryeredaktor i revistës periodike shkencore Studime Biologjike.

Si njohës i shkëlqyer i natyrës Jani ka dhënë ndihmesën e tij të veçantë në njohjen dhe ruajtjen e biodiversitetit. Rezultatet e punës së tij këmbëngulëse i ka paraqitur në botimet e dhjetëra artikujve shkencorë, monografive, teksteve universitare, në konferenca të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndër veprat dhe botimet më të shquara do të përmendnim: bashkëautor në Flora e Shqipërisë e Flora Ekskursioniste e Shqipërisë, drejtues dhe redaktor shkencor i “Excursion Flora of Albania”, botuar në Gjermani në vitin 2015, autor i Fjalorit Shpjegues të Terminologjisë së Botanikës, i Atlasit të Florës së Shqipërisë, vol. I dhe vol. II, i Fjalorit të emrave të bimëve.

Për veprën e tij madhore “Atlas i Florës së Shqipërisë”, vepër që përbën një domosdoshmëri në studimet e thelluara për florën tonë dhe që do të ndihmojë në studimet e tjera në fushën e pyjeve, kullotave, bimëve aromatike e mjekësore, farmaceutikës, leksikografisë, u nderua me çmimin më të lartë të Akademisë së Shkencave në fushën e shkencave natyrore-teknike, “Petrë Radovickë”.

Pjesë e veprimtarisë së tij të shumanshme janë edhe botimet Pyjet e paprekura të Shqipërisë, Libri i Kuq (Bimë, shoqërime bimë dhe kafshë të rrezikuara), Botanika, Gjeobotanika, si dhe kontributi si bashkautor i Map of the Natural Vegetation of Europe – Hartës së bimësisë natyrore të Europës, i botuar në Gjermani, në vitin 2000.

Akad. Jani Vangjeli ka zhvilluar dhe një veprimtari të gjatë, dhjetëra vjeçare, në fushën e mësimdhënies pranë Departamentit të Biologjisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, duke kontribuar me njohuritë e profesionalizmin e tij në formimin e gjeneratave të tera specialistesh të lartë. Në këtë kuadër ai dallohej për aftësitë e tij didaktike, pasionin në mësimdhënie, për qartësinë dhe saktësinë shkencore, për transmetimin me kompetence të reja shkencore duke fituar njëkohësisht dashurinë dhe respektin e kolegeve e të brezave të shumtë të studentëve.


Me ndarjen nga jeta të akademik emeritus Jani Vangjelit, Akademia e Shkencave humbet një nga anëtarët e vyer të saj në shkencat natyrore-teknike, një kërkues shkencor të përkushtuar dhe një koleg të shkëlqyer.

Duke i shprehur ngushëllimet më të përzemërta familjes së Janit, bashkëshortes e koleges tonë Shpresës, dy vajzave të tij, Amantina dhe Jona, motrave, miqve, kolegëve e bashkudhëtarëve të tij, në nderim e respekt të Jetës së anëtarit tonë të shtrenjtë, si falënderim e mirënjohje për veprën e tij, ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje.

I paharruar qofsh miku ynë!

www.akad.gov.al

Fjala e lamtumirës në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave për akademik emeritus Jani Vangjelin, nga sekretarja shkencore e ASHSH-së, akad. Anila Hoda



I nderuar Z. Kryetar i Akademisë së Shkencave, Akad. Gjinushi

E dashur prof. Shpresa, të dashura Amantina dhe Jona, familjarë të të ndjerit

Të nderuar anëtarë të Akademisë së Shkencave

Të nderuar përfaqësues të bashkësisë shkencore dhe miq të akademik Jani Vangjelit

Të nderuar të pranishëm

Në këtë moment të dhimbshëm, jemi mbledhur sot, sipas traditës dhe detyrimit tonë ligjor dhe moral, për të organizuar këtë ceremoni solemne në nderim të një prej figurave më të ndritura të shkencës shqiptare, akademik Jani Vangjeli.

Kjo ceremoni zhvillohet në përputhje me rregulloren për ceremonitë zyrtare të Akademisë së Shkencave dhe ka si qëllim nderimin e kontributeve të vyera shkencore,

njerëzore dhe qytetare të tij, duke i kujtuar ato me mirënjohje para jush, përfaqësuesve të bashkësisë shkencore dhe familjarëve të tij të dashur.



Akademik Jani Vangjeli, një nga figurat më të spikatura të shkencës shqiptare, ishte një studiues i shquar, një akademik i përkushtuar dhe një qytetar shembullor. Me përkushtimin dhe vizionin e tij, ai kontribuoi në avancimin e shkencës në fushën e florës dhe vegjetacionit të Shqipërisë, duke lënë pas një trashëgimi të pasur që do të vazhdojë të frymëzojë breza të rinj. Punimet e tij, të vlerësuara gjerësisht si brenda, ashtu edhe jashtë vendit, përfaqësojnë një kontribut të jashtëzakonshëm në ndriçimin e çështjeve komplekse dhe në nxitjen e përparimit shkencor.

Të gjithë jemi dëshmitarë të përmasave të tij si njeri dhe si shkencëtar. Për kolegët dhe studentët e tij, akademik Jani Vangjeli ishte një profesor dhe drejtues frymëzues. Për familjen e tij, një shtyllë mbështetëse dhe burim dashurie të pashtershme. Për ne të gjithë, ai mbetet një shembull i përkushtimit të pashoq ndaj dijes dhe vlerave njerëzore.

Kujtimi dhe veprimtaria e tij do të jetojnë përtej kësaj dite, duke mbetur gjithmonë pjesë e historisë sonë dhe e ndërgjegjes kolektive të komunitetit shkencor.

Me mirënjohje të thellë për gjithçka që ai na ka dhënë, shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta për familjarët e tij dhe për të gjithë ata që ndajnë këtë humbje të madhe.

Lamtumirë, akademik Jani Vangjeli. Trashëgimia juaj do të mbetet gjithmonë e paharruar. Pusho në paqe.

www.akad.gov.al

Letër ngushëllimi për ndarjen nga jeta të Kryepiskopit prof. dr. Anastas Janullatos



Drejtuar: Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë,
Sinodit të Shenjtë, Tiranë
Të nderuar hirësi,

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Ju shpreh ngushëllimet më të thella, për fjetjen në Zotin të Kryepiskopit të ndjerë të Tiranës, Durrësit dhe të Gjithë Shqipërisë, prof. dr. Anastas Janullatos!

Ndarja e Tij nga jeta fizike, përveçse një humbje e dhimbje për Ju dhe për mbarë komunitetin orthodhoks në Shqipëri, është gjithashtu një humbje edhe për botën akademike.

Si figurë e shquar e akademizmit në fushën e religjionit e teologjisë (anëtar nderi i Akademisë së Athinës, profesor emeritus i Universitetit Kapodistrian, doktor nderi në 19 universitete të ndryshme të botës etj), Ai njihet dhe vlerësohet edhe për 24 librat e përkthyer në mbi 17 gjuhë të botës, si dhe përmbi 240 studime dhe artikuj teologjikë dhe fetarë në shkencën e historisë së feve, dialogun ndër fetarë dhe bashkëekzistencën

paqësore të popujve dhe feve.

Tek personaliteti i Tij unik gërshetoheshin kleriku i përkushtuar me njeriun e dashur, profesori e studiuesi me drejtuesin e institucioneve religjioze, intelektualit me vizionarin që punoi për dashurinë dhe për paqen mes njerëzve.

E paharruar trashëgimia e Tij në të mirë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë!

Kryesia

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Tiranë më 25 janar 2025

www.akad.gov.al

Ndahet nga jeta akademik Minir Dushi, një figurë e shquar e shkencës dhe arsimit në Kosovë dhe në hapësirën mbarëshqiptare

-Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë i dërgon letër ngushëllimi Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës-



Letër ngushëllimi

Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës

I nderuar akad. Mehmet Kraja, të dashur kolegë,

Me dhimbje të thellë Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë përcjell ngushëllimet për ndarjen nga jeta të akademik Minir Dushit, një figure madhore e shkencës dhe arsimit në Kosovë dhe në hapësirën mbarëshqiptare.

Akademik Minir Dushi ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e xehetarisë dhe metalurgjisë, si dhe ka luajtur një rol kyç në themelimin dhe drejtimin e institucioneve të rëndësishme shkencore dhe arsimore në Kosovë.

Trashëgimia e tij akademike mbetet një pasuri e çmuar për brezat e ardhshëm,

ndërsa veprat dhe përkushtimi i tij ndaj arsimit kanë lënë gjurmë të pashlyeshme, duke ndihmuar në vendosjen e themeleve për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit dhe kërkimit shkencor në vend. Roli i tij në themelimin dhe forcimin e Universitetit të Prishtinës përbën një tjetër arritje madhore që do të kujtohet ngahera. Si zëvendësrektor i parë dhe më pas rektor i këtij institucioni, ai e drejtoi atë me vizion dhe përkushtim, duke kontribuar në ngritjen e standardeve akademike dhe në edukimin e një brezi të ri shkencëtarësh dhe profesionistësh të talentuar.

Në këtë moment pikëllimi, ne bashkëndajmë me ju dhe familjen e Tij dhimbjen për këtë humbje pa kthim. Kujtimi dhe vepra e akademik Minir Dushit do të mbeten gjithmonë frymëzim për të gjithë ata që i shërbejnë dijes e përparimit shkencor. Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Tiranë,

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Tiranë, 27 Janar 2025

www.akad.gov.al